



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 4 korrik 2012

ISSN 2225-2959




9 772225 295004

**Bankat: IA DALIM RRITJES
SË MODERUAR EKONOMIKE!**



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

AAB ofron për bankat anëtare një mundësi me kosto të ulëta për trajnimin e punonjësve.



ANETARËT E AAB

 ALPHA BANK

 BKT
BANKA KOMBETARE TREGTARE

 CREDINS bank

 CBA
CREDIT BANK OF ALBANIA
BANKA E KREDITIT TE SHQIPTARE

 Emporiki Bank
CREDIT AGRICOLE GROUP

 Fibank
First Investment Bank

 Banka Nderkombetare Tregtare
International Commercial Bank

 INTESA SANPAOLO BANK
Albania

 NBG Bank

 ProCredit Bank

 Raiffeisen
BANK

 SOCIETE GENERALE
ALBANIA

 TIRANA
BANK

 UNION
BANK

 UBA
United Bank
of Albania
Banka e Bashkuar
e Shqiptare

 VENETO BANKA
GRUPPO VENETO BANCA

■ www.aab.al

Përmbajtja

EDITORIAL

Bankingu mes rritjes së moderuar ekonomike dhe nxitjes së huadhënies nga *Elvin MEKA*

f.5

TEMA E DITËS

Bankat dhe rritja e moderuar ekonomike nga *Alexander SZOLNAI*

f.6

Përbalja dhe menaxhimi i krizës nga *Kaan PEKIN*

f.7

Zhvillimi aktual ekonomik dhe nevoja për një model të ri partneriteti bankë-biznes nga *Selami XHEPA*

f.8

Bankat përballë ciklit rënës të ekonomisë nga *Klodian TOMORRI*

f.9

INTERVISTA

Obligacionet e korporatave - Risia e fundit në Sistemin bankar shqiptar nga *Artan SANTO*

f.11

SISTEMI BANKAR

Huatë me probleme dhe fshirja e tyre nga bilanci - pasojat në rezultatin dhe ecurinë e sistemit bankar nga *Eljona HOXHA (KONOMI)*

f.12

Mashtrimi me kartat - si e luftojnë bankat fenomenin nga *Klodian Tomori*

f.16

Agrobiznesi dhe nevoja për financim nga bankat nga *Anjeza KELMENDI*

f.17

Dërgesat e emigrantëve në kontekstin ndërkombëtar – Pjesë jetike e ekonomisë në vendet në zhvillim nga *Souren HAYRIYAN*

f.19

FORUMI I EKSPERTËVE

Si t'i lexojmë pasqyrat statutore financiare të bankave kundrejt pasqyrave SNRF nga *Arten ZIKAJ*

f.21

KËNDI I EKONOMISTIT

Kriza bankare - Pse po vuan Spanja? nga *Adrian CIVICI*

f.25

PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE

RRJETI BALLKANIK

Lajme ndërballkanike

f.33

TEKNOLOGJI

Rëndësia e modelimit në sektorin bankar nga *Petraq PAPAJORGJI*

f.37

AUDITORI FINANCIAR

Kultura ekonomike dhe lidhja me shërbimet e produktet bankare në Shqipëri nga *Arbi AGALLIU*

f.39

AAB

Shoqata Shqiptare e Bankave për zhvillimin e burimeve njerëzore

f.42



BANKIERI është publikimi më i ri zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili do t'i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. BANKIERI do t'i japë lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arrijet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

Bankieri

Nr. 4, korrik 2012

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Redaksia:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Klodian Tomorri

Bashkëpunëtor

Junida Katroshi (Tafaj)

Koordinatorë Produktiviteti

Sonila Krashi

Design & Layout

Besa Vila

Redaktore

Gert Hoxha

Fotograf

Bordi Editorial:

Seyhan PENCABLIGIL

Kryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Banka Kombëtare Tregtare

Ioannis KOUGIONAS

Nënkryetar i AAB - së & Drejtor i Përgjithshëm, NBG Bank

Christian CANACARIS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Raiffeisen Bank

Flutura VEIPI

Anëtare e Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtuese e Drejtorisë Ekzekutive, Procredit Bank

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri

Periklis DROUGKAS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm Alpha Bank Albania

Endrita XHAFERAJ

Sekretare e Përgjithshme, Shoqata Shqiptare e Bankave

Hysen ÇELA

Menaxher, NH EuroConsult

Adrian CIVICI

Drejtor, Shkolla Doktorale Universiteti Europian i Tiranës

Spiro BRUMBULLI

Rektor - Tirana Business University

Enkelejda SHEHI

Kryetare e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", KULLAT BINJAKE Kulla I, Kati 6-të, A3, Tiranë

Tel: +355 4 2280 371; Fax: +355 4 2280 359

E-mail: bankieri@aab-dl.org; www.aab.al

Kredia për Shtëpi Alpha Komfort

Bëni realitet planet e një jete të tërë për një strehë komode duke përfutur nga fleksibiliteti i kredisë për shtëpi Alpha Komfort, e cila ju jep mundësinë të kombinoni normat fikse të interesit për një periudhë 1 ose 3 vjeçare me normat e ndryshueshme, duke e bërë kështu edhe me të thjeshtë dhe të sigurtë vendimin tuaj. Normat e shkëlqyera të interesit në të dyja rastet ju sigurojnë këste mjaft të përballueshme të gjithëve ju që po zgjidhni shtëpinë tuaj. Përfitoni gjithashtu nga një periudhë deri në 25 vjet për shlyerjen e kredisë.

Me kredinë për shtëpi Alpha Komfort, nuk keni pse mendoheni më gjatë!

Kredia me porosi



ALPHA BANK

BANKINGU MES RRITJES SË MODERUAR EKONOMIKE DHE NXITJES SË HUADHËNIES



nga Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

Sistemi bankar shqiptar duhet të përmbushë rigorozisht standardet rregullatore, ndërkohë që duhet të kujdeset për cilësinë dhe mbarëvajtjen e huadhënies, në një kohë që kërkesa për hua është në nivele të ulta, e kur vetë bankat duhet domosdoshmërisht të nxisin këtë kërkesë të klientelës për hua!

Lajmi më i “nxehtë” e më i rëndësishëm i të Gjithë kronikave informative ishte pa dyshim ai që ekonomia shqiptare regjistroi një rënie në raport me fundin e vitit 2011. Tashmë ekonomia kombëtare po e ndjen dhe përjeton shtrëngimin e rënies ekonomike në rrafsh global e veçanërisht, situatën komplekse ekonomike në Itali dhe Greqi, si dy nga partnerët kryesorë e më të rëndësishëm ekonomikë dhe tregtarë për Shqipërinë.

Rrjedhimisht, lajmi i mësipërm është më shumë se i “nxehtë”, veçanërisht për sistemin bankar, e jo vetëm. Argumenti këtu është mëse i qartë. Bankat kryejnë një biznes të veçantë, i cili në thelb ushqen dhe njëkohësisht lubrifikon, motorin e ekonomisë, i cili mendohet se është gjithnjë i ndezuar e në gjendje pune. Por, ndërkohë që depozitat, si një bekim i veçantë, vijojnë të rriten vazhdimisht, huadhënia po bëhet një “sport” i vështirë. Kjo situatë e huadhënies nuk shkaktohet nga shtrëngimi i standardeve të bankave për huadhënie, më shumë sesa nga niveli dhe potenciali i kërkesës nga vetë klientët. Pak rëndësi ka fakti, nëse ky nivel i kërkesës për hua nxitet nga faktorë psikologjikë, ose financiarë; çështja në themel këtu është kërkesa e moderuar, madje e dobët, e klientëve për hua. Ky fakt e komplikon shumë ekuacionin ekonomik, pasi konsumi përbën mbi dy të tretat e PBB-së e nëse kësaj i shtojmë dhe elementin e investimeve, atëherë peisazhi ekonomik bëhet

më i plotë. Prodhimi industrial po djersin, e ky tregues është tepër domethënës për bankat. Dukshëm, struktura aktuale e ekonomisë ngjan me një matricë të shpalosur SWOT, të cilën bankat e lexojnë dhe e kuptojnë për mrekulli, minimalisht për arsye të pozicionimit taktik të aktivitetit të tyre.

Në këto kushte, sistemi bankar shqiptar po përballlet me një detyrë të vështirë, ose thenë më mire, me një tufë detyrash të vështira. Atij i duhet të përmbushë rigorozisht standardet rregullatore, ndërkohë që duhet të kujdeset për cilësinë dhe mbarëvajtjen e huadhënies, në një kohë që kërkesa për hua është në nivele të ulta, e kur vetë bankat duhet domosdoshmërisht të nxisin këtë kërkesë të klientelës për hua! Praktikisht, bankat nuk janë para zgjidhjes së një ekuacioni ekonomik; ato ndodhen përpara një sistemi kompleks ekuacionesh, me zgjidhje të vështira. Shtrohet pyetja: A mund të gjejnë bankat zgjidhjet përkatëse? Sigurisht që PO! Çdo problem e ka një zgjidhje të caktuar. Sistemi bankar shqiptar, si pjesë e sistemit ekonomik, mund të japë zgjidhjet e duhura për çështjet dhe problemet e vështira, për sa kohë është i mirëkapitalizuar dhe likuid.

Së fundi, bankat drejtohen e menaxhohen nga bankierë profesionistë dhe me eksperiencë, të cilët janë gjithnjë mbi kreshtën e dallgës!!!

¹ Përgjegjës i Departamentit të Financës, UET

BANKAT DHE RITJA E MODERUAR EKONOMIKE



nga Alexander SZOLNAI
Zëvendëskryetar i Bordit Drejtues
RAIFFEISEN BANK

Rënia e rritjes ekonomike në të gjithë rajonin, ashtu si edhe në Shqipëri, nuk është domosdoshmërisht shqetësuese. Ne thjesht duhet t'i marrim normat aktuale ashtu siç janë dhe të përshtatim strategjitë tona të biznesit. Sigurisht që kjo është një situatë sfiduese, por do të jetë realiteti i ri në vitet në vazhdim.

Dhe këtu mund të them që, si në Shqipëri, ashtu dhe në të gjithë rajonin, ndoshta nuk do të ketë të njëjtat norma rritjeje si përpara vitit 2008. Kështu që kreditimi do të bëhet një burim jo i mjaftueshëm, çdo financim i ri do të verifikohet me më shumë kujdes nën kriterin risk/kthim dhe aktive të peshuara me rrezik (RWA). Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke qenë se ekzistojnë kërkesa të reja dhe më të larta për kapital për Grupet e mëdha Bankare Europiane, të cilat gjithashtu duhet të plotësohen. Prioriteti i parë sigurisht është të mbështesim klientët ekzistues si dhe projektet në këtë kohë sfiduese dhe të japim këshillim profesional për klientët tanë, për mënyrën sesi duhet të reagojnë ndaj rrethanave të reja. Gjithashtu, produktet dhe shërbimet

Jetojmë ende në kohë rritjeje, pra nuk gjykohen të përshtatshme ndryshime drastike në strategji, por bankat e kanë të nevojshme të bëhen më eficiente dhe të kenë një menaxhim më efektiv të kostove

e reja (si për shembull, menaxhimi i cash-it) synohet të përmirësojnë situatën. Gjithsesi, jetojmë ende në kohë rritjeje, kështu që unë nuk shoh ndonjë ndryshim drastik në strategji. Një prioritet kyç është mbështetja e sektorit privat nëpërmjet huave konsumatore dhe hipotekore, si dhe duke përmirësuar situatën në tregun e ngrirë të pasurive të paluajtshme. Nga ana tjetër ka shumë projekte të tjera të mëdha infrastrukture në fazën e planifikimit që do të ishte e domosdoshme të mbështeteshin dhe unë shpresoj që këtu të ketë bashkëpunim ndërmjet bankave për akordimin e huave sindikale. Përveç huave të biznesit ka edhe shumë shërbime të tjera që duhet të zbatohen në treg, disa prej tyre tashmë janë prezantuar, si për shembull, mobile banking, fondet e investimit, etj. Kështu, duke pasur më parë norma më të ulëta rritjeje të të ardhurave, del nevoja që bankat të bëhen më eficiente dhe të kenë një menaxhim më efektiv të kostove. Kur bëhet fjalë për përfitueshmërinë, duhet të them që niveli i provigjioneve për humbjet nga huatë me prob-

leme është tejet i lartë. Kështu, është mjaft e rëndësishme për të gjithë sistemin ekonomik që, ekzekutimi i kolateraleve dhe procedurat gjyqësore lidhur me to, të funksionojnë. Nuk është ky problemi aktual, por prioriteti kryesor është përmirësimi i këtij procesi.

Stimulimi i kërkesës për hua nuk mund të ndikohet vetëm nga bankat, duke qenë se ajo duhet të vijë nga klientët. Gjithsesi, për shembull, ne jemi në fillim të një fushate për huatë konsumatore, ku ofrojmë normat më tërheqëse në treg. Kur bëhet fjalë për biznesin, është e rëndësishme që, për çdo investim të ri, të ketë një plan biznesi solid dhe një projektim financiar të përcaktuar. Nga ana e huasë, në treg ekzistojnë të gjitha produktet e nevojshme, kështu që këtu nuk shoh ndonjë problem. Gjithsesi ajo që bankat duhet të përmirësojnë është mënyra sesi financimi mund të strukturohet për klientin. Financimi duhet t'i përshtatet saktësisht nevojave për qarkullimin e parasë.

Prioriteti i parë sigurisht është të mbështesim klientët ekzistues si dhe projektet në këto kohë sfiduese dhe të japim këshillim profesional për klientët tanë, për mënyrën sesi duhet të reagojnë ndaj rrethanave të reja.

PËRBALLJA DHE MENAXHIMI I KRIZËS



nga Kaan PEKIN
Drejtor i Grupit të Thesarit
dhe Institucioneve Financiare
BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Lajmet e mira janë të pakta kohët Le fundit. Ecuria e bankave në përgjithësi ka qenë e mundimshme gjatë viteve të fundit, për shkak të dy krizave të njëpasnjëshme ekonomike, që e patën filluesin në SHBA nga falimentimi i Lehman Brothers, duke vazhduar më tej me krizën e borxheve në eurozonë, pasojat e të cilës kanë detyruar tashmë pesë shtete të kërkojnë ndihmë financiare, duke i dhënë jetë spekulimeve, lidhur me një shpërbërje të mundshme të monedhës së përbashkët. Mospërputhja e normës së interesit midis shteteve kredidhënëse të Evropës Veriore, si: Gjermania dhe Holanda, ku kostot e huamarrjes janë në pikën më të ulët të të gjitha kohërave dhe në shtetet debitorë të Evropës Jugore, si: Spanjë dhe Itali, ku normat e interesit të obligacioneve janë rritur në nivelet e paraperiudhës euro, mund të shkaktojë një divergjencë të vazhdueshme. Meqenëse vlerësimet e qeverive dhe normat e interesit të obligacioneve vendosin një dysheme për kostot e huamarrjes së bankave dhe bizneseve në juridiksionin e tyre, bankat ose shoqëritë më të mira spanjolle dhe italiane duhet të paguajnë shumë më tepër për huatë, sesa koleget e

Nëse bankat nuk do të mund të ofronin kredi për një arsye ose një tjetër, përfitimi i sistemit bankar bie dhe i gjithë sistemi ekonomik hyn në një krizë recesioni më të thellë, që do të pasojë nga një kolaps i sistemit financiar.

tyre gjermane apo holandeze. Dy Operacione Rifinancimi të mëdha Afatgjatë (LTRO) i huave të lira trevjeçare (me një normë prej 1.0%) në sistemin bankar të eurozonës këtë vit, në shumën prej 1,000 miliardë euro, ndikuan vetëm për pak muaj. Bankat nuk janë të predispozuar për të dhënë hua për shoqëritë në sektorin privat, nga paratë me interes të ulët që ato përfituan. Disa banka tashmë kanë njoftuar se ato mund të shlyejnë para kohe një pjesë të fondeve të huazuara nga Operacionet e Rifinancimit Afatgjatë (LTRO) të Bankës Qendrore Evropiane (ECB). Gjithashtu, Autoriteti Bankar Evropian (EBA) u kërkoi bankave evropiane të rrisnin normën e mjaftueshmërisë së kapitalit, nga 8.0% në 9.0%, në fund të gjysmës së parë të vitit 2012, me synim rritjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së sistemeve bankare, por në fakt EBA thjesht trazoi follenë e

grenxave. Aksionerët e bankave, nuk mundën të injektonin ndonjë kapital të ri, por zvogëluan oreksin për të dhënë hua, për shkak të nevojës për të rindërtuar kapitalin. Largimi nga të ashtuquajturat “aktivet me rrezik”, u kthye në një largim nga aktivet e Evropës Juglindore. Kjo ka pasojat për koston dhe disponibilitetin e huasë për bizneset dhe konsumatorët në një rajon, përfshirë këtu dhe Shqipërinë dhe termi “de-risk” është tashmë i dukshëm.

Unë e përcaktoj biznesin bankar si artin e menaxhimit të aktiveve. Nëse bankat nuk do mund të ofronin hua, për një arsye ose një tjetër, përfitimi i sistemit bankar bie dhe i gjithë sistemi ekonomik hyn në krizë recesioni më të thellë, që do të pasojë me një kolaps të sistemit financiar. Në kohë të tilla krizash, bankat e kursimit dhe ato të shitjes me pakicë, që kanë një model biznesi të përshtatur jo vetëm për aksionerët, por edhe për palët e interesuara, mund të fokusohen më shumë në huadhënien me pakicë, çka do t'i bënte më pak të ndikuar nga kriza. Bankat me një model të tillë biznesi, gjithashtu e vendosin likuiditetin e tyre të tepërt në aktive krahasueshmërisht më të sigurt gjatë periudhës së krizës, për të qëndruar me fitim dhe në gatishmëri për të ofruar kredi të reja sektorit privat, që në momentin e parë të shenjave të rikuperimit ekonomik. Një politikë e tillë mund të tingëllojë si mbrojtëse, por është vërtetuar si alternativa më e mirë, në favor të ekonomisë dhe sistemit financiar.

Largimi nga të ashtuquajturat “aktivet me rrezik”, u kthye në një largim nga aktivet e Evropës Juglindore dhe kjo ndikon mbi koston dhe disponibilitetin e huasë një rajon, përfshirë këtu dhe Shqipërinë.

ZHVILLIMI AKTUAL EKONOMIK DHE NEVOJA PËR NJË MODEL TË RI PARTNERITETI BANKË-BIZNES



nga Dr. Selami XHEPA
Deputet

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

Pas një periudhe të gjatë në pozicionin e “bukuroshes së fjetur”, ku klasifikohet Shqipëria deri në fillimin e viteve 2000-jë, dekada e dytë e tranzicionit shënoi fillimin e një “bumi” të huasë në ekonomi. Dekada e parë e tranzicionit, e fokusuar në reformat stabilizuese të liberalizimit, krijoi kushtet e përshtatshme për rritjen e sektorit bankar e për thellimin financiar. Megjithatë Shqipëria pati një shkallë relativisht të lartë të thellimit financiar (matur si raport i agregatit monetar M3/PBB-së), kjo iu dedikua kryesisht niveleve të larta të borxhit publik dhe financimit monetar të tij, gjatë kësaj periudhe. Ndërmjetësimi financiar u përqendrua kryesisht në marrëdhëniet e sistemit bankar me qeverinë qendrore, ndërkohë që huaja për ekonominë mbetej në nivele të ulëta. Si një pjesë e rëndësishme e reformave strukturore të kësaj faze përmendet dhe hyrja e fuqishme e bankave të huaja, qoftë si “green-field”, apo nëpërmjet privatizimit, siç

Bizneset edhe bankat duhet të ripërshtasin presupozimet e tyre bazë në planin e huadhënies, duke filluar një proces të rëndësishëm të ristrukturimit të huave, për të shmangur maksimalisht vështirësimin e likuiditetit me të cilin përballen firmat, përballë rënies së shitjeve apo të aktivitetit të tyre ekonomik.

ishin BKT-ja dhe Banka e Kursimeve. Kështu, Shqipëria ishte ndër vendet e para të rajonit, ku ky sektor dominohej tërësisht nga bankat e huaja, thuhet të gjitha me origjinë nga vendet e BE-së. Rritja e huasë për ekonominë (sipas tabelës në vijim) ka qëndruar në nivelet e “bumit të huasë” (zakonisht rritja e huasë quhet “bum” kur ritmi i rritjes së saj është dy herë më i lartë se rritja e PBB-së). Ky ritëm përshpejtohet ndjeshëm pas vitit 2004, ku raporti hua/depozita do të rritej nga 19%, në mbi 62%, në fund të vitit 2011. Literatura përgjithësisht identifikon tre faktorë kryesorë, që shoqërojnë “bumin” e huadhënies: (1) gjatë fazës së zhvillimit ekonomik, huaja rritet më shpejt se rritja ekonomike; (2) huaja rritet me ritme më të shpejta se rritja ekonomike gjatë një cikli ekonomik në rritje, për shkak të nevojave në rritje për kapital punues dhe investimeve nga ana e firmave, dhe (3) zgjerimi i përshpejtuar i huasë mund të ndodhë dhe për shkak të një reagimi të papërshtatshëm të agjentëve të tregut financiar ndaj ndryshimeve të rrezikut përgjatë kohës. Sipas

“modeleve të përshpejtuesit financiar”, mbioptimizmi për fitimet në të ardhmen, çon në një mbivlerësim të vlerës së aktiveve, rritje të hyrjeve të kapitaleve, rritje të vlerës së kolateralit dhe lejon që firmat dhe ekonomitë familjare të huazojnë më shumë dhe të shpenzojnë më shumë. Por nëse ecuria e biznesit bie nën nivelet e pritshme, atëherë vihet në lëvizje një proces prapësues, duke pamundësuar shërbimin e huasë dhe aksesin ndaj huave të reja. Këto faktorë luajnë një rol kyç, si në shtrirjen në kohë të problematikës në tregun e huasë, ashtu dhe në ashpërsinë që shoqëron procesin e përshtatjes dhe rikthimit në një gjendje të re të ekuilibrit. Në praktikë, është e vështirë të dallohen se cili nga këta tre faktorë e ka ushqyer rritjen e huasë, ashtu sikurse ka qenë e pamundur të përcaktohet një nivel “optimal” i rritjes së kreditimit që mund të ndihmojë politikëbërësit të ndikojnë në ruajtjen e këtij niveli “optimal” dhe të shmangin rrezikun e një rënieje të kredisë. Kështu, edhe vetë Banka e Shqipërisë e ka të vështirë të vendosë ndonjë objektivi të një tregue-

	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Huaja ndaj depozitave	8.4	9.1	10.2	13.5	15.7	19.0	28.5	37.4	47.4	62.8	66.6	61.7	62.1
Ritmi rritjes së huasë	12.1	16.9	20.2	38.3	31.1	38.1	74.3	56.8	50.4	35.1	13.3	9.7	12.2
Ritmi rritjes së GDP	14.0	7.0	8.0	4.0	6.0	6.0	6.0	5.0	5.9	7.5	3.3	3.9	2.7

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti Statistikor

...partneriteti bankë-biznes duhet të vendoset mbi një filozofi të re, të një vizioni dhe marrëdhënieje afatgjatë, i parë jo vetëm si një përfitim reciprok afatshkurtër për ta, por dhe si një përgjegjësi shoqërore dhe publike.

si "optimal" të huasë për ekonominë, si tregues operacional i punës së saj mbikëqyrëse e monitoruese.

Lidhur me zhvillimet që kanë filluar të vërehen në tregun e huasë, duke filluar nga viti 2009, dëshmohet një rënie e theksuar në ritmet e rritjes së saj, që evidenton dhe shfaqjen e problemeve që shoqërojnë procesin e përshtatjes dhe axhustimit. Rënia e ritmeve të rritjes ekonomike, ndikuar dhe nga kriza globale e ajo rajonale, kanë bërë që cikli i biznesit të jetë në rënie. Kështu, si bizneset edhe bankat duhet të ripërshtasin pritshmëritë e tyre bazë në planin e huadhënies, duke filluar një proces të rëndësishëm ristrukturimi të huave, për të evituar vështirësimin e likuiditetit me të cilën përballen firmat, nga rënia e shitjeve apo e aktivitetit të tyre ekonomik. Në këto rrethana, këshilla për qeveritë që "të jenë të shtrënguara në kohë "bumi" ekonomik dhe dinamike në kohë rënieje ekonomike", vlen dhe për bankat, të cilat duhet të adoptojnë të njëjtën filozofi. Një biznes në vështirësi likuiditeti, shpejt apo vonë do të kalonte drejt paafësisë së plotë paguese, kështu që, nëse bankat do të shtrëngonin kushtet e tyre në momentet e një cikli ekonomik rënës, vetëm do të rrezikonin të çonin bizneset drejt dështimit, duke rrezikuar dhe dështimin e vetvetes. Ajo që mbetet imperative sot është që, partneriteti bankë-biznes duhet të vendoset mbi një filozofi të re, të një vizioni dhe marrëdhënieje afatgjatë, i parë jo vetëm si një përfitim reciprok afatshkurtër për ta, por dhe si një përgjegjësi shoqërore e publike, ku dhe Banka e Shqipërisë, me mekanizmat që ka në dispozicion, mund të japë një mbështetje të vyer në këtë drejtim.

BANKAT PËRBALLË CIKLIT RËNËS TË EKONOMISË



Ngritja e një sistemi të shëndoshë financiar ka qenë pa dyshim një faktor përcaktues në qëndrueshmërinë makroekonomike dhe në zhvillimin e ekonomisë shqiptare, gjatë dekadës së fundit. Pas krizës financiare të vitit 1997, privatizimi i bankave i hapi rrugën lindjes së një sistemi financiar modern, që sot është pa dyshim një nga vlerat më të çmuara të ekonomisë. Ishte ky sistem që mundësoi rritjen me një hov shpërthyes të ndërmjetësimit financiar në ekonomi, duke bërë të mundur financimin e sipërmarrjes private dhe aktivitetit ekonomik në tërësi. Huaja për ekonominë u rrit në mënyrë eksplozive dhe ky zgjerim kaq i shpejtë i ndërmjetësimit financiar luajti një rol kritik në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, ku sipas Bankës së Shqipërisë rezultoi se, e vetme, kredia për ekonominë ka mundësuar që PBB-ja të rritet mesatarisht nga 1.5-2 % më shumë në vit. Natyrisht që kjo periudhë e zhvillimeve impulsive në tregun financiar përkooi me periudhën e rritjes së shpejtë ekonomike, duke e ndikuar dhe duke u ndikuar njëherazi prej saj. Por ekonomiksi na mëson se ekonomia e tregut zhvillohet me cikle. Tashmë shumica e ekonomive të zhvilluara, ndodhen prej mëse 4 vitesh në ciklin rënës të biznesit, ndërsa ekonomitë e tjera në zhvillim po përballen me një ngadalësim të fortë të aktivitetit ekonomik. Këto zhvillime ndërkombëtare nuk kishin si të mos preknin dhe ekonominë shqiptare, sot shumë më e integruar, duke pasur si efekt kryesor ngadalësimin e ritmeve të zhvillimit të saj. Pas vitit 2008 rritja ekonomike ka zbritur në nivelet më minimale të 20 viteve të tranzicionit. Ky ngadalësim i aktivitetit ekonomik dhe pasiguritë e shtuara nga kriza kanë ndikuar dhe mbi sistemin financiar, në drejtim të rritjes së huave me probleme dhe rënien e ritmit të huadhënies për ekonominë. Tashmë, rritja vjetore e huasë është tkurrur dukshëm, duke kushtëzuar financimin e investimeve të reja dhe të konsumit. Kjo nuk është çështje likuiditeti, pasi sistemi bankar shqiptar vijon të mbetet shumë likuid dhe një nga më të mirëkapitalizuarit në rajon. Raporti hua/depozita luhet rreth nivelit 65 %, dukshëm më i ulët sesa mesatarja e rajonit prej 106 %, çka tregon se bankat shqiptare kanë ende hapësirë dhe likuiditet për të financuar ekonominë, por pasiguritë e shtuara në treg, i kanë bërë ato më të kujdesshme. Kuptohet lehtë që, situata ekonomike komplekse e Italisë dhe Greqisë, si partnerët kryesorë ekonomikë të Shqipërisë, përcjell nervozizëm e pasiguri dhe në tregun shqiptar. Përtej pasojave të pritshme, kriza globale financiare nxori në pah disa dobësi të hershme të sistemit financiar, jo domosdoshmërisht të vetë bankave, por të mjedisit ku ato operojnë, si:

- (1) paqartësitë e lidhura me titujt e pronësisë dhe dobësia e zbatimit të kontratave, që ndikojnë në rritjen e portofolit të huave me probleme dhe pasigurive në sistemin financiar, të cilave bankat iu përgjigjën duke shtuar kujdesin dhe shtrënguar standardet e huasë;
- (2) situata komplekse politike, sidomos pas vitit 2009, ka krijuar një situatë pritshmërie në ekonomi dhe në sistemin financiar; dhe
- (3) informaliteti i lartë, veçanërisht në tregun e punës, që vështirëson gjykimin e drejtë të aftësisë paguese të huamarrësve, duke përkeqësuar cilësinë e portofolit. Historia na ka treguar se shumë kriza kanë shërbyer si pika kthese, duke nxitur politika dhe zgjidhje eficiente, që kanë përmirësuar mjedisin ekonomik. Ky mund të jetë një rast i mirë edhe për Shqipërinë, pasi në fund të fundit këto sfida nuk janë vetëm të sistemit financiar, por dhe të ekonomisë dhe të shoqërisë në tërësi.

nga Klodian TOMORRI

DEPOZITA MIQTË



☎ 04 22 34 096 @ www.bankacredins.com

Kush sjell një mik përfiton një thesar

- Përmes Depozitës Miqtë, JU përfitoni rritje të normës së interesit. Nëse sillni një mik të ri që të çelë një depozitë, JU dhe miku juaj do të keni një rritje të normës së interesit.
- Për të përfituar nga kjo ofertë, JU duhet patjetër të keni ose të çelni një depozitë me afat si dhe të sillni një mik të ri për të çelur një të tillë.
- Bonusi që ju përfitoni është 0.5% më shumë se normat e publikuara por në çdo rast norma e depozitës nuk mund të jetë më e lartë se 7% në monedhën lek, 4% në euro dhe 3% në dollarë.
- Depozita Miqtë ofrohet në afatet 6 mujore dhe 12 mujore.

Depozita Miqtë është e vlefshme deri më datë 15 Shtator 2012

 **CREDINS** bank

OBLIGACIONET E KORPORATAVE

Risia e fundit në Sistemin bankar shqiptar



Z. Artan SANTO
Drejtor i Përgjithshëm, CREDINS BANK

BANKIERI: - CREDINS BANK KA EMETUAR PËR HERË TË PARË NË SHQIPËRI OBLIGACIONE KORPORATASH. ÇFARË PËRFAQËSON KY INSTRUMENT PËR BANKËN DHE VETË SISTEMIN BANKAR?

Credins Bank për herë të parë në Shqipëri ka emetuar obligacione korporatash në fund të vitit 2011 si dhe në muajt e parë të këtij viti. Obligacioni përfaqëson një titull afatgjatë borxhi, që detyron Bankën t'i paguajë zotëruesit të obligacionit vlerën nominale dhe interesin, në mënyrë periodike, në një datë të caktuar. Ai është titull borxhi që përcakton të drejtën e investuesit për të marrë në datën e maturimit 100% të vlerës së investuar. Është një instrument shumë i rëndësishëm si për bankën, ashtu dhe për sistemin bankar në përgjithësi.

BANKIERI: - KUJT SEGMENTI KLIENTËSH I DREJTOHET KY TITULL FINANCIAR, PRA KUSH JANË MBAJTËSIT E SYNUAR DHE ATA FAKTIKË TË TIJ? SI ËSHTË OFRUAR KY TITULL NË TREGUN SHQIPTAR?

Ky lloj investimi fillimisht është menduar për klientë të veçantë të Credins Bank, të cilët kanë mundësi likuiditeti dhe duan të investojnë para në një produkt të sigurt, afatgjatë dhe fitimprurës. Obligacionet ofrojnë mundësinë e investimit me normë interesi shumë konkurruese, me alternativa të tjera të ngjashme në treg, por dhe japin një të ardhur fikse periodike, sipas kushteve të emetimit të tyre. Ky titull në tregun shqiptar është ofruar nëpërmjet ofertës (vendosjes) private.

Credins Bank është banka e parë shqiptare që emetoi, për herë të parë në sistemin financiar shqiptar, obligacione të korporatave

BANKIERI: - CILAT JANË DISA NGA TIPARET DHE ASPEKTET TEKNIKE TË KËTJË TITULLI?

Oferta për të nënshkruar këto tituj u drejtohet klientëve të besuar dhe të përzgjedhur nga Credins Bank, duke u ofruar një alternativë investimi të veçantë dhe shumë rentabël. Siç u përmend më sipër Banka detyrohet t'i paguajë zotëruesit të obligacionit interesin në mënyrë periodike, në një datë të caktuar.

Ky investim karakterizohet nga një normë e lartë interesi, që jepet në formën e kuponit gjashtëmujor ndërkohë që duhet pasur parasysh ngurtësimi i fondeve, i cili bëhet për një periudhë kohore 6 vjeçare. Pagesa e principalit bëhet në fund të periudhës, në formën "bullet payment".

BANKIERI: - PSE E GJYKONI ME SHUMË RËNDËSI DALJEN ME KËTË LLOJ TITULLI NË TREGUN SHQIPTAR?

Ky produkt është aq i ri në tregun bankar shqiptar, aq sa është i vjetër në tregjet financiare ndërkombëtare. Është shumë e rëndësishme për ne të mbulojmë kërkesat e një segmenti të veçantë klientësh, duke u dhënë atyre një alternativë investimi rentabël dhe duke grumbulluar në favor të bankës fonde të qëndrueshme dhe afatgjata, të cilat rrisin dhe diversifikojnë burimet e financimit, një aspekt ky shumë i rëndësishëm veçanërisht në kohën e sotme.

Ky lloj financimi i bankës me investues të përzgjedhur bëhet në zbatim të plotë të legjislacionit në fuqi për letrat me vlerë, si dhe nën mbikëqyrjen e plotë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që kontrollon në vazhdimësi procesin e emetimit të obligacioneve dhe transparencën ndaj klientit dhe nga Banka e Shqipërisë, e cila gjithmonë është e informuar për këtë lloj financimi.

BANKIERI: - A BËN PJESË NË PLANET AFATGJATA TË BANKËS EMETIMI I TYRE ME OFERTË PUBLIKE?

Emetimi i obligacioneve me ofertë publike është pjesë e planeve tona afatgjata. Qëllimi i Credins Bank është të jetë sa më afër klientëve të saj dhe investuesve, duke i mbështetur fuqishëm, duke i plotësuar nevojat dhe kërkesat e tyre me të gjithë gamën e produkteve, si dhe në çdo produkt të ri që tashmë ka treguar sigurinë dhe qëndrueshmërinë e tij në tregjet financiare ndërkombëtare.

HUATË ME PROBLEME DHE FSHIRJA E TYRE NGA BILANCI - PASOJAT NË REZULTATIN DHE ECURINË E SISTEMIT BANKAR



nga Eljona HOXHA (KONOMI)
Nëndrejto e Financës
NBG Bank

Sistemet financiare në mbarë botën morën një goditje të fortë gjatë viteve të fundit, që u shkaktuan nga kriza financiare globale e vitit 2008, e konsideruar nga një numër i madh ekonomistësh, si kriza financiare më e keqe që nga koha e Depresionit të Madh të SHBA-së, në vitet 30-të. Për shkak të globalizimit dhe ndërlidhjes së tregjeve financiare, efektet e saj ishin të menjëhershme në mbarë botën, duke rezultuar në kolapsin dhe "zhdukjen" e disa institucioneve të mëdha financiare, si dhe në humbjen e besimit në sistemin financiar. Transaksionet bankare në tregun financiar pësuan një ngrirje të përkohshme. Ndërhyrja e qeverive dhe e bankave qendrore të vendeve të zhvilluara ishte e menjëhershme, duke injektuar më tepër kapital dhe duke lehtësuar transaksionet në tregun e parasë, nëpërmjet uljes së normave bazë të interesit. Pavarësisht nga ndërhyrjet e qeverive dhe të bankave qendrore recesioni ekonomik, që pasoi, ishte i

Fshirja e huave mund të konsiderohet një nga mundësitë që bankat kanë për të menaxhuar situatat e shtrëngesave ekonomike, në kushtet e mungesave të likuiditetit dhe nevojave për kapitale shtesë

pamundur të evitohet për shumicën e ekonomive botërore të prekura nga kriza.

Natyrshëm lind pyetja: Cilat janë efektet e kësaj krize për vendin tonë? Në pamje të parë duket sikur Shqipëria nuk u prek nga kriza financiare botërore e viteve të fundit, por a është tërësisht e vërtetë se sistemi ynë financiar është i imunizuar ndaj

krizave financiare dhe ekonomike botërore? Bankat tregtare në Shqipëri janë universale, pra nuk ekziston asnjë kufizim ligjor në gamën e produkteve që mund të ofrojnë. Megjithatë shumëllojshmëria e investimeve të tyre është kryesisht e kufizuar në produktet tradicionale. Stadi modest i zhvillimit të sistemit financiar shqiptar si dhe mungesa e aktivitetit të investimit në produkte komplekse dhe me rrezik të lartë ka luajtur rolin e një mburoje mbrojtëse ndaj krizës financiare. Pikërisht mungesa e investimeve në produkte derivate ka bërë që ndikimi i parë i krizës financiare të ishte i pandjeshëm për tregun shqiptar. Nga ana tjetër, një analizë e thekshtë e strukturës së huasë në sistemin bankar shqiptar, tregon se mesatarisht rreth 70% e huave dhënë bizneseve dhe individë janë në monedhë të huaj. Në terma afatgjatë, huamarrja në valutë, ndërkohë që të ardhurat kryesore të popullsisë realizohen në monedhën vendase, lë hapësirë që aftësia paguese e huamarrësve të bjerë prë e luhatjeve të kursit të këmbimit. Rrezikun kryesor të këtyre luhatjeve e mbajnë individët, të cilët e kanë të pamundur ta transferojnë apo ta menaxhojnë këtë rrezik, siç mund të bëjnë bizneset. Zhvlerësimi i lekut rezultoi në shtrënjtimin e kështit të huasë, duke kufizuar në këtë

Fshirja e huave nga bilanci është një proces më burokratik sesa të tjerët të lartpërmendur, që kërkon plotësimin e disa kushteve bazë për realizimin e tij.

mënyrë aftësinë paguese të huamarësve. Vështirësimi i situatës ekonomike u pasqyrua në sistemin bankar nëpërmjet përkeqësimit të cilësisë së huasë dhe rënies së huadhënies. Konkretisht, nga viti 2009 huaja me probleme u rrit nga 10% e totalit të huasë në 14% në vitin 2010, 18.8% në 2011-ën e së fundi, në tremujorin e parë të 2012-ës arriti në vlerën 20%. Nga ana tjetër, ritmi i rritjes së huasë në sistemin bankar shënon një rënie të dukshme. Nga viti 2002 kjo rritje luhatej nga 35% - 55%, duke arritur kulmin në vitin 2005, ku rritja ka shënuar rekordin e saj me 74%. Ndërkaq në vitin 2009 rritja e huasë është vetëm 11%, në vitin 2010 ishte 10%, në 2011-ën arriti në 12%, gjithsesi larg nga periudha para vitit 2008.

Por cili është ndikimi i rritjes në vijim të huave me probleme? Huaja me probleme nënkupton që, kësti i planifikuar në programin e shlyerjes së huasë (kryegjësja + interesi) nuk paguhet në kohë (mbi 90 ditë me vonesë), ose nuk paguhet fare. Si rrjedhojë, kjo e ndikon bankën në disa mënyra: (1) mosshlyerja e këstit në afatin e caktuar, përkeqëson likuiditetin e bankës, (2) banka nuk realizon të ardhurat e parashikuara, duke ulur përfitueshmërinë e saj dhe (3) rritja e huave me probleme rrit fondin e provigjioneve në bilancin e bankës, duke çuar në rritje të shpenzimeve përkatëse për provigjionet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, rrjedhimisht duke rënduar edhe më shumë rentabilitetin e bankës.

Nga sa më lart, zvogëlimi i fitimit, ose rritja e humbjeve, i detyron bankat të shtojnë kapitalin e tyre, me qëllim sigurimin e raportit minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit, që aktualisht është në nivelin 12%¹. Duke pasur parasysh që një nga fenomenet që shoqëroi krizën financiare ishte pikërisht mungesa e likuiditetit, sigurimi i kapitaleve shtesë nga bankat (mëmë) përbën një proces të vështirë.

Kush janë rrugëzgjdhjet që i ofrohen bankave në një situatë të tillë? Në praktikën e bankave më të përhapura rrugëzgjdhjet janë disa, si: (1) krijimi i departamentit të mbledhjes së huave (collection), që ndjek në mënyrë taktike ecurinë e klientëve me probleme, në mënyrë që t'i paraprijë përkeqësimeve të mundshme, (2) ristrukturimi i huave me qëllim përshtatjen e afatit kohor dhe madhësisë së këstit me mundësitë aktuale të ndryshuara të klientit, (3) fshirja e huave me probleme nga bilanci i saj. Fshirja e huave nga bilanci është një proces më burokratik, krahasuar me të tjerët e lartpërmendur, që kërkon plotësimin e disa kushteve bazë për realizimin e tij si, për shembull, (1) klasifikimin e huasë si të "humbur" dhe (2) kryerjen dhe përfundimin e procesit ligjor për kthimin e huasë, ose për ekzekutimin e kolateralit. Kjo procedurë ka filluar të zbatohet nga disa banka në vend. Në parantezë, vlen të theksohet se një rol të veçantë në përsheptimin e procesit të ekzekutimit të kolateralit ka luajtur

Fshirja e kredive nga bankat mund të japë shkëndijën e parë, për të dalë nga situata aktuale që mbizotëron brenda këtij sektori.

dhe zgjerimi i kuadrit legjislativ, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.10,031 datë 11.12.2008, për krijimin dhe funksionimin e përbarimit privat.

Fshirja e huave nga bilanci mund të rezultojë në tre skenarë të ndryshëm:

1. Sipas skenarit të parë, banka vendos të fshijë huanë e humbur nga librat e saj, para se të ekzekutojë kolateralin. Fshirja e huasë në vetvete, nuk do të kishte asnjë efekt pozitiv në treguesit e bankës. Huaja dhe fondi i provigjioneve, i krijuar për të, fshihet nga bilanci pa shkaktuar asnjë ndryshim në vlerën e aktivit. Kjo, sepse huaja e humbur, sipas rregullave të Bankës së Shqipërisë, është provigjionuar me 100%, duke e çuar vlerën e saj neto në bilanc zero, që në momentin e klasifikimit si "e humbur" (në bilanc, huaja ka tepriçë debitore, provigjioni ka tepriçë kreditore, pra rezultantja është zero). Ndërkaq, fshirja e huasë do të rezultojë në zerimin e provigjioneve në pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, si dhe në riklasifikimin e së njëjtës shumë në një zë tjetër humbjesh, duke mos ndikuar mbi rezultatin financiar. Sa më sipër, ky skenar



¹ Për bankat e themeluara me kapital grek, për qëllime sigurie, Banka e Shqipërisë ka kërkuar që ky raport të jetë 15% që nga dhjetori i vitit 2011.

normë interesi duke
filluar nga B.Th.+2.3%



Kredi për Rregullim Shtëpie



4 22 66 288 | www.bkt.com.al

APLIKONI TANI

- Kredi deri në 12,000,000 Lekë
- Maturim deri në 10 vjet
- Këste të përballueshme

Shtojini vlerat shtëpisë tuaj!



nuk ka efekt në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit (Kapital rregullator/APR). Kapitali rregullator zvogëlohet me rritjen e humbjeve, ose me zvogëlimin e fitimit (humbja/fitimi mbartur + humbja/fitimi vitit), ndërkaq që huaja ponderohet për vlerën e saj neto (hua – provigjion). Sipas skenarit në fjalë, asnjëri nga elementet e këtij raporti nuk ndryshon.

2. Sipas skenarit të dytë, banka është në gjendje të ekzekutojë kolateralin e lidhur me huanë, duke e kaluar atë në aktiv të bankës. Në

këtë rast, ekzekutimi i kolateralit dhe kalimi i tij në aktiv të bankës ndikon në dy mënyra: (i) aktivi i bilancit do të rritet me vlerën e kolateralit të ekzekutuar, duke rritur njëkohësisht dhe vlerën e aktiveve të ponderuara me rrezik (ky aktiv ponderohet me 100%), (ii) rezultati financiar do të përmirësohet me vlerën e kolateralit të ekzekutuar, i cili regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si e ardhur. Në shikim të parë, duket se efekti në mjaftueshmërinë e kapitalit do të jetë përsëri zero, pasi ekzeku-

timi i kolateralit nga njëra anë përmirëson kapitalin rregullator me vlerën e kolateralit, e nga ana tjetër zmadhon aktivet e peshuara me rrezik me të njëjtën vlerë. Gjithsesi, kuadri rregullator në fuqi, lë hapësirë për bankat që të përfitojnë nga ky proces. Kështu, interesat e huave të këqija kontabilizohen vetëm për 90 ditët e para të vonesës. Nga ana tjetër, sistemet informatike të bankave, llogarisin interesin deri në momentin e fshirjes së huasë. Pikërisht kjo diferencë rezulton në përmirësim të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Siç u theksua dhe më lart, mjaftueshmëria e kapitalit ndikohet nga kapitali rregullator, i cili zvogëlohet me rritjen e humbjeve, domethënë zvogëlohet me çdo provigjionim shtesë të huasë dhe përmirësohet me shtimin e fitimit, pra rritet me të ardhurat e regjistruara nga ekzekutimi i kolateralit. Kur të ardhurat e regjistruara nga kolaterali janë më të mëdha sesa shpenzimi i provigjionimit të regjistruar në të kaluarën, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit përmirësohet.

3. Sipas skenarit të tretë, që është më i preferuari, por dhe më i vështiri për t'u realizuar, banka ekzekuton dhe realizon vlerën monetare të kolateralit të lidhur me huanë, e humbur, në një nga ankandet e organizuara nga shërbimi përmbarrimor. Këtu, përveç përmirësimit të përmendur në skenarin e dytë, kemi dhe zvogëlimin e aktiveve të ponderuara me rrezik, pasi *cash*-i ponderohet me 0%, duke çuar në rritje më të madhe të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Për më tepër, kthimi i kolateralit në *cash* përmirëson dhe likuiditetin e bankës. Ky skenar, megjithëse më efikas, has vështirësi në praktikë edhe nga mungesa relative e likuiditetit me të cilën po përballlet ekonomia sot, duke kufizuar transakcionet e shitblerjes.

Si përfundim, mund të thuhet se, pavarësisht nga vështirësitë me të cilat po përballlet ekonomia shqiptare, e në veçanti sistemi bankar, mund të gjenden rrugëzgjidhje, qoftë dhe nëpërmjet procesit të fshirjes së huave, që përmirësojnë sadopak situatën aktuale, duke nxitur vazhdimin e aktivitetit bazë të secilit sektor.

MASHTRIMI ME KARTAT - SI E LUFTOJNË BANKAT FENOMENIN

Në vitin 2004, Shqipëria numëron vetëm 30 mijë përdorues të kartave bankare duke qenë kështu një nga tregjet më të pazhvilluara në rajon. Por pas atij viti, masat e ndërmarra kundër informalitetit në ekonomi dhe inovacionet e sjella nga bankat kanë bërë që përdorimi i kartave si instrumente pagese të rritet me ritme shpërthyes. Vitin e kaluar sistemi përpunoi rreth 11.5 milionë transaksione përmes kartave, me një vlerë prej 118 miliardë lekësh. Kjo rritje është e mirëpritur, sepse dëshmon për formalizimin e ekonomisë dhe reduktimin e parasë *cash* në ekonomi, por gjithsesi me një efekt anësor. Sa më shumë rritet biznesi aq më shumë ai ekspozohet ndaj rrezikut të mashtrimit. Vitin e kaluar sistemi i pagesave u përball me tri sulme, ku më i rëndi ishte ai i organizuar nga 5 shtetas bulgarë, të arrestuar përmes një operacioni spektakolar. Sipas të dhënave zyrtare vitin e kaluar u regjistruan rreth 1,415 transaksione mashtrimi me një vlerë totale prej afro 222 mijë euro. "Tendencat në rritje të mashtrimeve me karta është shqetësim jo vetëm për sistemin bankar, por edhe për gjithë industrinë e pagesave. Megjithatë në vlerë nominale Shqipëria vazhdon të ketë nivelin më të ulët të humbjeve si pasojë e mashtrimeve në krahasim me Europën apo dhe me mesataren globale", thotë Enkelejd Balliu, kryetarë e Komitetit Kundër Mashtrimeve me Karta, një njësi e posaçme e ngritur pranë Shoqatës Shqiptare të Bankave.

Skemat e mashtrimit

Deri më tani dy kanë qenë skemat më të përdorura të mashtrimit. E para është ajo e kopjimit të shiritit magnetik, që përmban të dhënat konfidenciale të kartave, nëpërmjet vendosjes së pajisjes kopjuese në bankomate, ku çdo kartë që përdoret në të, është e rrezikuar nga kopjimi. Ky ishte rasti i përdorur nga 5 shtetasit bulgarë. Skema e dytë e përdorur ishte vjedhja e informacionit të kartave të përdorura



në Greqi nga viti 2010 deri në korrik të vitit 2011, si pasojë e vjedhjes së të dhënave ndaj një nga përpunuesve me të mëdhenj grekë të transaksioneve me karta, EURONET.

Rreziku

Sipas statistikave Shqipëria nuk hyn në vendet me rrezik të lartë të mashtrimeve bankare, "por si një vend ku

industria e kartave është në zhvillim ajo konsiderohet "e lakmueshme" për piratët e kartave," thotë Balliu. Piratët e kartave e transferojnë përgjithësisht veprimtarinë e tyre në vendet në zhvillim, atje ku institucionet janë ende të brishta dhe të pakonsoliduara dhe në rastet më të shumta janë individë të mirëfinancuar, të mirëorganizuar dhe të arsimuar. Aq shpejt sa

ZHVILLOHET FORUMI I DYTË KUNDËR MASHTRIMEVE

Forumi i Dytë Kombëtar Shqiptar Kundër Mashtrimeve, i organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave dhe Komiteti i saj për Luftën Kundër Mashtrimit me Karta zhvilloi punimet e tij në datë 10 maj 2012, në Hotel Sheraton, në Tiranë. Forumi i Parë me të njëjtën përmasë u zhvillua në 15 prill 2011, në Tiranë.

Zhvillimin e eventit të dytë të këtij Forumi e nderuan me pjesëmarrjen e tyre Z. Hysni BURGAJ, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Shqiptar, dhe Z. Ioannis KOUGIONAS, Zëvendëskryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave.

Në Forum u diskutuan zhvillimet kryesore të industrisë së kartave, por edhe për sa i përket ndjekjes dhe kapjes së tyre. Fjala kryesore e Forumit ishte konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit të bankave me autoritetet e ligjit në Shqipëri me qëllim zhvillimin e sigurt të kësaj industrie, që është çelësi kryesor për mbrojtjen e reputacionit të biznesit të kartave, bankave si dhe për mbrojtjen e reputacionit të vendit tonë.



ecën teknologjia për të krijuar masa mbrojtëse, po aq shpejt përshtaten edhe kriminelët. Bankat i kushtojnë vëmendje të posaçme mbrojtjes nga mashtrimet dhe bashkëpunimi i tyre për këtë çështje është në nivelin më të lartë. Vetë krijimi i Komitetit të Luftës Kundër Mashtrimeve është dëshmia më e qartë e burimeve njerëzore, ose financiare që bankat kanë mobilizuar për të mbrojtur industrinë e pagesave. Krijimi i tij ka bërë të mundur koordinimin, mbledhjen e informacionit dhe përpunimin në një kohë optimale, duke reduktuar humbjet dhe duke ndihmuar në investigimin dhe zbulimin e rasteve. "Falë këtij bashkëpunimi ne kemi arritur rezultate të shkëlqyera në identifikimin e rasteve të mashtrimit si dhe në marrjen e masave parandaluese", sqaron Balliu.

Masat

Bankat kanë ndërmarrë një sërë masash për të luftuar rastet e mashtrimit. Pjesa më e madhe e tyre kanë lëshuar kartat e reja CHIP, të cilat janë më të vështira për t'u kompromentuar. Paralelisht, pjesa më e madhe e bankomateve janë të pajisur me kamera dhe vazhdojnë të pajisen, duke aplikuar teknologjitë më të avancuara. Një pjesë e mirë e bankave kanë instaluar pajisje antikopjuese në ATM dhe pajisje, të cilat bëjnë të pamundur leximin e tastierës nga kamerat. "Me nismën e Komitetit të Luftës kundër Mashtrimeve, bankat ranë dakord dhe aplikuan së bashku në rang vendi standardet më të larta të sigurisë, për tregtarët më të ekspozuar në shpërdorimin, transmetimin apo ruajtjen e të dhënave të kartave. Komiteti bashkëpunon me një sërë partnerësh strategjikë, veçanërisht me Visa-n, e cila ka qenë dhe nismëtarja e krijimit të tij, por edhe me MasterCard-in. "Po ashtu ne bashkëpunojmë me zyrën Ligjore të ambasadës amerikane në Tiranë, OPDAT, e cila trajnon dhe mbështet Prokurorinë dhe Policinë shqiptare në luftën kundër krimit financiar dhe korrupsionit", pohon kryetarja Balliu. Por bashkëpunimi kryesor është me policinë e Shtetit. Për vitin 2011 në sajë të bashkëpunimit të ngushtë me Komitetin dhe bankat, Policia realizoi 4 operacione dhe vuri në pranga 14 persona. "Ky bashkëpunim është vlerësuar pozitivisht edhe nga ekspertët e Komisionit Europian dhe nga Këshilli i Europës, në takimet me strukturat e Policisë së Shtetit dhe është përcjellë si shembull i mirë për vende të tjera në rajon", përfundon Balliu.

nga Klodian TOMORRI

AGROBIZNESI DHE NEVOJA PËR FINANCIM NGA BANKAT

nga Anjeza KELMENDI
Drejtoresh e Sektorit të Agrobiznesit
ProCredit BANK

Bankat i kanë shërbyer me modesti bujqësisë, sepse kjo është parë si një sfidë që bart në vetvete një shkallë të lartë rreziku, të cilin bankat nuk kanë dashur ta ndërmarrin, pavarësisht se t'i shërbesh këtij sektori është një sfidë e domosdoshme që duhet ndërmarrë

Sektori i agrobiznesit në Shqipëri është një sektor i rëndësishëm në zhvillim për ekonominë tonë, por që përballet me sfida dhe probleme jo të vogla. Roli i këtij sektori pasqyrohet jo vetëm në peshën prej 18% që zë në prodhimin e brendshëm bruto, por dhe në krijimin e vendeve të punës për rreth 50% të popullsisë. Vitet e fundit në bujqësi ka pasur rritje të dukshme në disa drejtime si, për shembull, në sektorin e perimeve në serrat diellore apo në frutikulturë dhe kjo falë nismave, ose nxitësve të politikave bujqësore nga njëra anë, por edhe nxitjes së konkurrencës brenda dhe jashtë vendit.

E sotmja, por dhe e ardhmja paraqet sfida dhe mundësi të mëdha për zhvillimin e këtij sektori në Shqipëri. Mundësitë më të mëdha lidhen drejtpërdrejt me marrjen e statusit të vendit kandidat në BE, që do të hapte ndër të tjera rrugën e fondeve të konsiderueshme për mbështetjen e agrobiznesit shqiptar dhe që do të kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të vendit. Pavarësisht se Shqipëria nuk e ka fituar ende këtë status, është vendosur që t'i jepet një fond test, IPARD LIKE, në vlerën 8.2 milionë euro, që do të përdoret për të zbatuar programin e masave të aprovuar nga Brukseli. Ky fond parashikohet që të fillojë në korrik të vitit 2012 (kur starton dhe thirrja e parë për aplikime nga bizneset) dhe mbaron në fund të vitit 2013.

Këto mundësi shoqërohen dhe me sfida, për të arritur kriteret e përfitimit nga bizneset, por që këto biznese të bëhen përfituese të këtyre fondeve duhet të plotësojnë një sërë kushtesh thelbësore të miratuara që lidhen me anën ligjore të biznesit, me kompetencën teknike, ose me standardet për mbrojtjen e mjedisit dhe të sigurisë ushqimore etj. Gjithashtu, përdorimi i fondeve të BE-së është



i lidhur ngushtë me ekzistencën, ose me operimin e sistemit bankar në sektorin e bujqësisë dhe të blegtorisë, duke qenë se rregulli kryesor i BE-së është rimbursimi i zbatimit të projekteve fituese të IPARD-it. Është pikërisht sektori privat bankar ai që duhet të tregojë efikasitet në drejtim të furnizimit të sektorit bujqësor me kapital, por gjithashtu të bëjë të mundur edhe përthithjen maksimale të fondeve të akorduara nga BE-ja.

Financimi i nevojave të agrobiznesit në Shqipëri, sfidat dhe problematikat

Pavarësisht nevojave të larta në sektorin e agrobiznesit për investime dhe financime afatgjata, realiteti tregon se ai mbetet sektori me përqindjen më të ulët të financimit nga sistemi bankar. Vetëm rreth 1.5% të portofolit të huave e zë agrobiznesi, kundrejt 34% që zë prodhimi, ose 25% që zë tregtia. Ky proces bëhet edhe më i vështirë për këta klientë kur përfshihen kërkesat për garanci hipotekore, ose forma standarde pagese të huave, të cilat kërkojnë fleksibilitet më të lartë dhe ekspertizë teknike në shërbim. Prandaj dhe në këtë sektor shihet një prirje e theksuar për vetëfinancim apo për financime jozyrtare, megjithëse e shoqëruar me një nivel të lartë kursimi. Sistemi bankar po mundohet ta ndryshojë këtë perceptim prandaj gjatë dy viteve të fundit ky sistem duket gjithnjë e më i fokusuar në këtë sektor, ndonëse ende me shumë nevoja dhe hapësira për investime e riorganizime. Bankat i kanë shërbyer me modesti bujqësisë, pasi kjo e fundit është parë si një sfidë të cilën nuk kanë dashur ta ndër marrin. ProCredit Bank është gjithsesi banka e parë që e ka mbështetur dukshëm këtë sektor, duke rrezikuar pavarësisht pasigurisë dhe vështirësive që ai mbart. Aktualisht, ProCredit Bank ka financuar rreth 21 mijë klientë, me një shumë financimi prej rreth 82 milionë euro.

Vështirësitë që ProCredit Bank ka hasur në angazhimin e saj në huadhënien drejt agrobiznesit, sikundër dhe çdo bankë tjetër, mund të përmblihen në këto drejtime: (1) problematika gjithnjë e pranishme lidhur me pasuritë dhe certifikimin e tyre si mundësi për ofrim garancie, (2) informaliteti i lartë si në strukturë dhe në

ProCredit Bank, falë eksperiencës afatgjatë me këtë grup të synuar klientësh dhe falë punonjësve të profilizuar e të specializuar për t'i shërbyer këtij grupi dhe për të plotësuar nevojat që kanë këta ka ndërr-marrë:

- analizimin dhe krijimin e shërbimeve financiare për këtë grup, në funksion të ciklit dhe të nevojave të këtij biznesi. Banka ofron financime për bizneset e reja (që quhen Start-Up businesses), të cilat janë më shumë të ekspozuara kundrejt rrezikut, por janë dhe një mundësi e madhe për ekonominë shqiptare.
- projektin e quajtur "Trekëndëshi i Bashkëpunimit për Zhvillim". Në këtë zinxhir marrëdhëniesh, banka synon një funksionim sa më të mirë të të gjitha hallkave, që do të çojnë në rritjen e efikasitetit dhe përfitueshmërisë për të tria palët. Sipas këtij projekti, me anën e shpërndarjes së informacionit më të fundit teknik, ekonomik dhe të tregut, lidhjes dhe orientimit të prodhuesve me përpunuesit, sigurohet një shpërndarje dhe plotësim i nevojës që ka secili biznes në kohën e duhur.



dokumentacion dhe (3) nevoja e madhe për eksperiencë teknike dhe informacione për fermerët dhe agropërpunuesit, me qëllim që të njihen me të rejat më të fundit të teknologjisë në fushën e agrobiznesit. Kjo ndikon në rritjen e produktivitetit dhe të efikasitetit të bizneseve të tyre.

Ndërkohë, lidhur me nevojat që ka sektori i agrobiznesit, ato mund të përmblihen shkurtimisht në: (1) siguria e tregut, ose shitja e sigurt e produkteve që ata prodhojnë. Pasiguria e tregut bujqësor krijon një pasiguri për agrobizneset. Jo pak herë, si rezultat i mungesës së mekanizmave kontrollues dhe rregullues të këtij tregu, këto biznese janë penalizuar, duke krijuar humbje të mëdha nga mosshitja e produkteve të tyre, (2) zhvillimi i sektorit të sigurimit të biznesit. Si një sektor me një rrezik të lartë nga faktorët atmosferikë, lind nevoja e krijimit të mekanizmave të sigurimit të këtyre bizneseve, të cilët do të rritnin nismat për investim (me një siguri më të

madhe), por njëkohësisht do të ishin një faktor pozitiv në uljen e rrezikut me të cilin ndeshen bankat në rastet e financimit të këtij biznesi dhe (3) ekzistenca e marrëdhënieve kontraktuale midis agrobizneseve. Komunikimi dhe fluksi i biznesit midis tyre është ende në nivele verbale dhe jo në forma ligjore dhe kontraktuale.

Sfidat dhe mundësitë në sektorin e agrobiznesit janë dy anë të së njëjtës medalje. Sfidat me të cilat përballlet sektori i agrobiznesit janë jo të vogla, por njëkohësisht duhet të ekzistojë dhe dëshira si dhe ekspertiza për të nxjerrë prej tyre mundësitë më të mira dhe për t'i vënë ato në funksion të zhvillimit të bizneseve dhe të vetë zonave rurale ku ato ushtrojnë aktivitetin. Ekonomia shqiptare ka nevojë për mbështetje dhe bankat, sikundër dhe ProCredit Bank, duhet të vazhdojnë të mbështesin këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë.

DËRGESAT E EMIGRANTËVE NË KONTEKSTIN NDËRKOMBËTAR – PJESË JETIKE E EKONOMISË NË VENDET NË ZHVILLIM



nga Souren HAYRIYAN
President & CEO
Unistream Commercial Bank

Paratë e dërguara nga emigrantët e tejkalojnë trefish totalin e ndihmës ndërkombëtare globale, e sigurojnë një mënyrë financimi me rëndësi jetike për miliona ekonomi familjare të varfra. Në kushtet kur mbi 3% e popullsisë së botës (mbi 215 milionë njerëz) jetojnë jashtë vendit të tyre të lindjes, dërgesat e emigrantëve kontribuojnë në jetesën e miliona njerëzve në mbarë botën. Për më tepër, transfertat e dërgesave mund të promovojnë aksesin e përfituesve dhe dërguesve të tyre në shërbimet financiare, duke rritur integrimin financiar dhe social.

Dërgesat e emigrantëve po luajnë një rol gjithnjë e më të madh, duke kontribuar në rritjen ekonomike të shumë vendeve dhe në jetën e personave me të ardhura modeste (që zakonisht nuk janë më të varfrit e të varfërve). Sipas Bankës Botërore, në vitin 2009, dërgesat e emigrantëve arritën në 414 miliardë dollarë, prej të cilave 316 miliardë dollarë drejt vendeve në zhvillim, duke përfshirë mbi 192 milionë punëtorë emigrantë. Nisur nga të dhënat e fundit, dërgesat e emigrantëve drejt vendeve në zhvillim, vlerësohen të kenë arritur në 372 miliardë dollarë në vitin 2011,

me një rritje prej 12.1%, krahasuar me vitin 2010. Me përjashtim të Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore, ritmi i rritjes së dërgesave të emigrantëve, në të gjithë rajonet e tjera, ishte më i lartë në vitin 2011 sesa në vitin 2010. Vlerësimet më të fundit tregojnë se, për vitin 2011, përfituesit më të mëdhenj të dërgesave të emigrantëve midis vendeve në zhvillim ishin: India, Kina, Meksika dhe Filipinet. Për disa vende përfituese, këto dërgesa mund të arrijnë sa një e treta e PBB-së. Meqenëse përfituesit e dërgesave të emigrantëve shpesh kanë prirje të kenë llogari bankare, këto dërgesa promovojnë aksesin në shërbimet financiare, një aspekt thelbësor ky i rolit të dërgesave të emigrantëve, për të promovuar zhvillimin ekonomik. Ndër përfituesit më të mëdhenj të dërgesave të emigrantëve, në terma të raportit të tyre ndaj PBB-së për vitin 2010, janë shumë ekonomi të vogla, si: Taxhikistani (31%), Lezoto (29%), Moldavia (23%) dhe Samoa (23%).

Pavarësisht krizës aktuale globale ekonomike, fluksi i dërgesave të emigrantëve pritet të vijojë rritjen, duke tejkaluar shifrën prej 593 miliardë dollarë në vitin 2014, nga të cilat 441 miliardë dollarë drejt vendeve në zhvillim.

Mundësitë në Shqipëri:

Një nga aktorët kryesorë në arenën globale të dërgesave të emigrantëve, UNISTREAM COMMERCIAL BANK, po shqyrton të gjitha mundësitë për të krijuar partneritete strategjike me rrjete të mëdha bankare në Shqipëri, me qëllim lehtësimin e transfertave të dërgesave të emigrantëve nga shqiptarët jashtë Shqipërisë. Fluksi vjetor i dërgesave të emigrantëve për në Shqipëri arrin rreth 1.2 miliardë dollarë (sipas raportit të Bankës Botërore), dhe rreth 11% e PBB-së, duke e bërë Shqipërinë, në

të ardhmen e afërt, një nga tregjet kryesore të synuara nga Unistream Bank. Meqë pjesa dërrmuese e emigrantëve shqiptarë janë vendosur në Europë, Unistream Bank do të synojë Italinë, Greqinë, Gjermaninë dhe Mbretërinë e Bashkuar, ku emigrantët mund të përdorin rrjetin e Unistream Bank, për të dërguar paratë e tyre në Shqipëri.

Si ofrues shërbimesh për dërgesat e emigrantëve me rritje të shpejtë, Unistream me seli në Moskë, gëzon pozita të forta veçanërisht në Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Greqi dhe Qipro, ku po përparon me shpejtësi, duke zhvilluar rrjetin nëpërmjet filialeve.

Ne besojmë se tashmë ka ardhur koha që institucionet financiare shqiptare të hyjnë në partneritet me një operator ndërkombëtar për dërgesat e emigrantëve, që ofron mundësi të reja biznesi për:

- zgjerimin e gamës së produkteve, duke shtuar shërbimet, pra avantazhet konkurruese në arenën ndërkombëtare;
- rritjes thelbësore të portofolit të klientëve;
- vënies në funksionim të një sistemi me tarifa të leverdishme dhe të përshtatshme, dhe tepër fleksibël lidhur me ndarjen e komisioneve midis partnerëve;
- rritjes thelbësore të nivelit të veprimtarisë ndërkombëtare, dhe promovimin e emrit të tyre në këtë arenë.



OFERTAT MË TË MIRA DHE KONKURUESE
NË TREGUN BANKAR!



CBA JU OFRON:

Depozita, llogari rrjedhëse dhe me afat, tranferta parash, garanci bankare,
shkembime dhe te gjitha sherbimet tradicionale bankare

Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi",
Ndërtesa Administrative "AL-KHARAFI" (prane Fakultetit
Juridik), Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2 272168/66; Fax: + 355 4 2 272162
E-mail: creditbkalb@icc-al.org
creditcba@icc-al.org

SheratonTirana Hotel
Shopping Plaza
Tel: +355 4 2 2255372/388/368/346
Fax: +355 4 2 255340

Hotel "Butrinti", Sarandë
Tel: +355 85 2254 05



nga Artur ZIKAJ
Drejtor i Divizionit të Financës
UNION Bank

Hyrje

Sipas ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*, duke filluar nga 1 janari i vitit 2008, entitetet financiare, përfshirë edhe bankat, duhet të përgatisin pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Për rrjedhojë, bankat janë të detyruara të përgatisin dhe të dorëzojnë pasqyrat financiare të audituara tek autoriteti i taksave dhe te Banka e Shqipërisë (BSH) mbi baza vjetore.

Në anën tjetër, për qëllime staturore, bankat janë gjithashtu të obliguara të përgatisin pasqyra financiare në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregulloret e BSH-së (më konkretisht ligji nr. 9662, datë 18.12.2006: *Për bankat në Republikën e Shqipërisë* dhe vendimin nr. 95, datë 24.12.2008: *Për miratimin e metodologjisë së raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare*). Duhet theksuar se pasqyrat financiare staturore, të përgatitura mbi bazën e kësaj metodologjie, duhet të dorëzohen mbi baza vjetore vetëm te BSH-ja. Përveç kësaj, kërkesat e BSH-së të tilla si: mjaftueshmëria e kapitalit, kapitali rregullator dhe raportet e tjera periodike, si pjesë e Sistemit të Raportimit të Unifikuar (SRU), përgatiten mbi bazën e parimeve kontabile sipas metodologjisë së BSH-së, përveç kërkesave rregullatore specifike të lidhura

SIT'I LEXOJMË PASQYRAT STATUTORE FINANCIARE TË BANKAVE KUNDREJT PASQYRAVE SNRF

Diferencat janë kryesisht në dy drejtime: përmbajtja dhe prezantimi i pasqyrave financiare dhe politikat e parimet kontabël, të cilat ndikojnë rezultatet financiare

me SRU-në. Ekzistenca e diferencave dhe e materialitetit të tyre në pasqyrat financiare të bankave varet nga kompleksiteti i transaksioneve dhe i aktiviteteve të tyre. Për rrjedhojë, asnjë publikim që krahason këto dy kategori të standardeve kontabël nuk mund të përfshijë të gjitha diferencat që mund të lindin në këtë kuadër. Më poshtë do të paraqesim më me hollësi diferencat, që i gjejmë më shpesh në praktikë aktuale, të ndara në dy drejtime: përmbajtja dhe prezantimi i pasqyra-

Ekzistenca e diferencave dhe e materialitetit të tyre në pasqyrat financiare të bankave varet nga kompleksiteti i transaksioneve dhe i aktiviteteve të tyre.

ve financiare dhe politikat kontabël që ndikojnë rezultatet financiare.

Përmbajtja dhe prezantimi i pasqyrave financiare

Përmbajtja e pasqyrave financiare është e ngjashme. Të dyja platformat e raportimit kanë katër pasqyrat financiare klasike të shoqëruara nga shënimet e pasqyrave financiare, megjithatë, diferencat kryesore janë prezantuar shkurtimisht më poshtë:

Terminologjia nuk është ekzaktësisht e njëjtë. Ndërkohë që raportimi në përputhje me SNRF-në evoluon në përputhje me BSH-në terminologjia e vjetër është në përdorim (për shembull, *Bilanci* në vend të *Pasqyra e pozicionit financiar*, *Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve* në vend të *Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave*, etj.)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për raportimin statutor nuk i përfshin të ardhurat e tjera të përgjithshme (*other comprehensive income*) siç është kërkuar së fundmi nga SNRF-ja. Po ashtu, për qëllime staturore, mund të gjeni në *Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve* termin *Shpenzime/Të ardhura të jashtëzakonshme*, ndërkohë që sipas SNRF-së ky koncept nuk ekziston më.

Elementet që duhet të paraqiten në pasqyrat financiare nuk janë ekzaktësisht të njëjta. Kjo vjen kryesisht nga frekuenca e ndryshimeve të SNRF-së

dhe prej aplikimit të këtyre ndryshimeve, ndërkohë që metodologjia e BSH-së është më shumë statike. Për shembull, SNRF-ja kërkon që *Aktivitetet jomonetare, të mbajtura për shitje*, të prezantohen në *Pasqyrën e bilancit*, ndërkohë që sipas raportimit për BSH-në këto aktive duhet të prezantohen në kategorinë *Aktive të tjera*; Sipas SNRF-së, *Pasqyra e flukseve të parasë* është përgatitur mbi bazën e një standardi specifik, ndërkohë që në rastin e raportimit statutor nuk ka një standard specifik të cilit duhet t'i referohemi.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar nuk duket se është një pasqyrë e detyrueshme për raportimin statutor, ndërkohë që sipas SNRF-së është e detyrueshme. Gjithsesi kjo pasqyrë zakonisht prezantohet edhe në pasqyrat financiare statutore.

Më poshtë listojmë ndryshimet kyçe në shënimet e pasqyrave financiare:

Kërkesat për përshkrimin e politikave kryesore kontabël sipas SNRF-së janë mjaft të zgjeruara dhe në një ndryshim të vazhdueshëm, ndërsa për BSH-në janë më të fokusuar dhe statike.

Sipas SNRF-së, kërkesat për shënimet e pasqyrave financiare gjithashtu janë mjaft të zgjeruara dhe në një ndryshim të vazhdueshëm. Si praktikë, çdo koncept trajtohet nën një stan-

dard specifik që mbulon kryesisht përkufizimet, njohjen, matjen dhe shënimet përkatëse. Për shembull, shënimet në lidhje me instrumentet financiare nën SNRF-në janë mjaft të zgjeruara, krahasuar me kërkesat sipas BSH-së. E njëjta gjë mund të thuhet për pasqyrat financiare të konsoliduara, zhvlerësimin e aktiveve, lizingun, raportimin e segmenteve të biznesit, etj.

Politikat dhe parimet kontabël gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare

Si pasqyrat financiare statutore, ashtu edhe sipas SNRF-së, përgatiten mbi bazë të parimeve të përcaktuara nën secilën kuadër raportues. Për rrjedhojë, lindin diferenca jo vetëm në prezantim, por edhe në rezultatet financiare. Politikat dhe parimet kryesore kontabël që ndikojnë rezultatet financiare të prezantuara në pasqyrat financiare listohen më poshtë: *Zhvlerësimi i aktiveve financiare (provizgjioni apo fondi rezervë)*. Sipas SNRF-së, një aktiv financiar, ose një grup i tillë (përfshirë huatë) është zhvlerësuar vetëm nëse ekziston një evidencë objektive zhvlerësimi si një rezultat i një apo disa ngjarjeve të ndodhura pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo (këto) ngjarje ka një ndikim në flukset e pritshme të parave për këtë aktiv, apo grup aktivesh financiare të cilat mund të vlerësohen me besueshmëri. Banka së pari kontrollon

nëse ekziston një evidencë objektive zhvlerësimi për aktivet financiare që janë individualisht të konsiderueshme. Nëse po, vlera e zhvlerësimit përcaktohet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme në të ardhmen, skontuar me normën fillestare të interesit efektiv. Nëse banka vë re se nuk ka një evidencë objektive zhvlerësimi për aktivet individualisht të konsiderueshme, nëse janë të konsiderueshme ose jo, i përfshin ato në grupin e aktiveve me karakteristika rreziku të ngjashme me to dhe po në grup i vlerëson ato për zhvlerësim. Për qëllime të një vlerësimi në grup për zhvlerësim, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të huasë. Zakonisht, bazuar në të dhënat historike për secilin prej këtyre grupeve llogaritet një faktor humbje i cili më pas përdoret për të vlerësuar zhvlerësimin për çdo grup.

Sipas rregullores për *Administrimin*

Tabelë 1

Kategoria e huasë	Norma e provigjonit
Standarde	1%
Në ndjekje	5%
Nënstandarde	20%
Të dyshimta	50%
Të humbura	100%

FINANCES

e rrezikut të kredive, që është baza për përllogaritjen e fondit rezervë të zhvlerësimit për pasqyrat financiare statutore, huatë klasifikohen në pesë kategori, mbi bazën e situatës financiare të huamarrësit, ditëve në vonesë etj. Në momentin që çdo hua është klasifikuar në një kategori të caktuar, për secilën kategori aplikohen normat e provigjionimit (për referenca Tabela 1). Është për t'u theksuar fakti se sipas BSH-së, vlera aktuale e pagesave të pritshme, ose vlera e kolateraleve, me përjashtim të rastit kur kolaterali është në para, nuk merret në konsideratë në përcaktimin e fondit rezervë të zhvlerësimit.

Si pasojë e këtyre diferencave, që lindin nga metodologjitë e aplikuara, provigjioni i huave i përllogaritur dhe i regjistruar në pasqyrat financiare statutore është i ndryshëm nga ai në ato sipas SNRF-së. Zakonisht, nisur nga fakti se qasja sipas BSH-së është më konservative, provigjioni i kontabilizuar në pasqyrat financiare statutore do të ishte më i lartë se ai në ato sipas SNRF-së dhe për pasojë fitimi statutor do të ishte më i ulët se ai i SNRF-së. Megjithatë, kjo është një diferencë e përkohshme pasi në momentin e ripagimit të huasë, rimmarrja e provizioneve në pasqyrat financiare statutore do të jetë më e lartë se ajo për SNRF-në, duke rezultuar në fitime më të larta. Për sa i përket prezantimit, sipas SNRF-së,

fondi i provigjionit prezantohet si një kundra-aktiv i kredive në *Pasqyrën e bilancit* (duke zvogëluar vlerën bruto të kredive), njësoj si dhe fondi i përllogaritur sipas tri kategorive të fundit sipas BSH-së. Fondi i provigjionit për dy kategoritë e para prezantohet në anën e detyrimeve.

Rivlerësimi i kapitalit. Sipas rregulloreve të BSH-së, kapitali në monedhë të huaj duhet të kontabilizohet me kursin e këmbimit të datës së veprimtimit në pasqyrat financiare dhe një rezervë e rivlerësimit e krijuar në kapitalin e aksionarëve, që përfaqëson diferencën në LEK ndërmjet kursit të përcaktuar nga BSH-ja, përdorur për të regjistruar kapitalin e paguar në monedhë të huaj (në kapitalin total, kjo bën që efektivisht kapitali aksionar të prezantohet me kursin në ditën e bilancit). Sipas SNRF-së, kapitali konsiderohet si një element jomonetar dhe për pasojë mbahet me koston historike. Si axhustim kundrejt pasqyrave statutore, për SNRF-në, kjo rezervë e rivlerësimit kthehet në *Pasqyrën e të ardhurave* e për rrjedhojë ndikohet edhe fitimi.

Tatimi i shtyrë. Nuk ka ndonjë kërkesë në rregulloret e BSH-së në lidhje me përllogaritjen dhe njohjen e tatimit të shtyrë, ndërsa sipas SNRF-së përveç tatimit aktual (që është detyrimi për tatimin mbi bazë të fitimit

të tatueshëm dhe mbi bazë të ndonjë axhustimi të mundshëm që rrjedh nga vitet e mëparshme) bankat duhet të njohin edhe tatimin e shtyrë (që matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi është likuiduar apo aktivi është realizuar, bazuar në normat e tatimit që janë në fuqi në datën e raportimit). Si pasojë e njohjes së tatimit të shtyrë në bazë të SNRF-së, shpenzimi i taksës dhe për rrjedhojë edhe fitimi neto do të afektohej.

Amortizimi. Në pasqyrat financiare statutore, amortizimi i aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara përllogaritet sipas metodës lineare me norma amortizimi vjetore të përcaktuara (20-25%). Sipas SNRF-së, amortizimi bëhet mbi bazën e jetës së pritshme në përdorim të një aktivi. Përveç kësaj, SNRF-ja njih se disa aktive të paprekshme me jetëgjatësi të papërcaktuara nuk amortizohen, por testohen për zhvlerësim mbi baza vjetore. Në rast se metoda e amortizimit sipas SNRF-së do të rezultojë në norma të ndryshme vjetore (ose në numër periudhash që një aktiv duhet të amortizohet), ose në identifikimin e aktiveve të paprekshme me jetë të papërcaktuar, amortizimi që do të prekte llogaritë e fitim/humbjes do të ishte i ndryshëm.



Emporiki Bank

CRÉDIT AGRICOLE GROUP

Anëtare e Grupit më të Madh Bankar në Francë

KRIZA BANKARE - PSE PO VUAN SPANJA?



nga Prof. Dr. Adrian CIVICI
Drejtor i Shkollës Doktorale
Universiteti European i Tiranës

Problemi gjendet te modeli i financimit dhe i huadhënies nga bankat, të cilat duke “kopjuar” modelin anglo-sakson të financimit, privilegjuan interesat tregtare në kurriz të standardeve të menaxhimit të rrezikut, duke dhënë shumë kredi imobiliare, pa u shqetësuar për aftësinë paguese të klientëve të tyre

Deri para 3-4 vitesh, Spanja citohej si një shembull i jashtëzakonshëm suksesi, si një mrekulli ekonomike, si vend me rritje ekonomike, dukshëm mbi mesataren e eurozonës, me papunësi nën 5%, me borxh publik prej 36% në raport me PBB-në. Por, përtej këtyre shifrave impresionuese, me sa dukej, maskoheshin disekuilibra të rëndësishëm makroekonomikë e financiarë. Aktualisht, sektori bankar në veçanti, por dhe vetë ekonomia spanjolle, ndodhen në një udhëkryq të rrezikshëm dhe në një krizë shqetësuese, jo vetëm për Spanjën, por për gjithë eurozonën. Dalja në dritë e problematikës së bankës “Bankia”, një nga katër bankat më të mëdha të vendit, hapi “kutinë e Pandorës” për gjithë sistemin bankar spanjoll. Guvernatori i Bankës së Spanjës dha dorëheqjen një muaj përpara se t’i mbaronte mandati, duke i shtuar një pikëpyetje më shumë dyshimeve. “Bankia” i kërkoi qeverisë ndihmë, fillimisht 23.5 miliardë euro në maj të 2012-ës, duke e zbritur më vonë në shumën prej 19 miliardë eurosh, për t’u rikapitalizuar, por BQE-ja reagoi duke deklaruar se nuk do të lejonte që Spanja të shfrytëzonte financimin e saj për të rikapitalizuar “Bankia”-n, apo banka të tjera në vështirësi.

Qeveria iu përgjigj se mund t’i shpëtonte vetë bankat dhe pa ndërhyrjen e BQE-së. Por, për tregjet financiare, që nuk e mbështesin aspak logjikën “donkishoteske” të kalorësit të vetëm shpëtimtar, ky ishte sinjali i largimit nga bonot e thesarit dhe nga titujt e tjerë financiarë të bankave spanjolle. Normat e interesit për bonot e thesarit shkuan menjëherë në 6.7%, ose 5.15% më të larta se interesat e bonove gjermane, duke iu afruar

kështu rrezikshëm nivelit prej 7%, që detyroi pak kohë më parë Greqinë, Irlandën dhe Portugalinë që t’i drejtoheshin për ndihmë BE-së. Ministri spanjoll i Buxhetit, Cristobal Montoro, e cilëson këtë përqindje të lartë interesi si treguesin kryesor se: “Spanjës po i ngushtohet frikshëm aksesit në tregjet financiare”. Presioni i tregjeve u bë shumë i fortë duke e detyruar qeverinë e kryeministrit, Rajoy, që t’i drejtohej për “...asistencë financiare BE-së, për të mbështetur vendin e tij dhe për të shpëtuar sistemin bankar që gjendet në vështirësi të mëdha”. Problemet më urgjente janë “financimi dhe rikapitalizimi i bankave, çështjet e likuiditetit, dhe shërbimi i borxhit”. Rruga më e preferueshme do të ishte blerja e borxhit spanjoll nga BQE-ja, por një shpresë e tillë nuk po gjen mbështetjen e duhur nga BQE-ja, që ka pushuar së bleri borxhet e vendeve të ndryshme anëtare të eurozonës.

Problemi kryesor qëndron te madhësia e ekonomisë, që renditet e katërta në zonën euro dhe përfaqëson 12% të PBB-së së saj, ndërkohë që Irlanda, Portugalia dhe Greqia së bashku përfaqësonin vetëm 6% të PBB-së të saj. Por,


planet e shpëtimit për këto vende deri tani kanë kushtuar përkatësisht 85 miliardë, 78 miliardë dhe 292 miliardë euro, duke treguar se nëse bëhet fjalë për të shpëtuar Madridin, shifrat do të jenë shumë më të mëdha. Megjithë refuzimin e deritanishëm të Spanjës për t’iu nënshtruar një “plani shpëtimi që do t’i humbte asaj sovranitetin buxhetor”, institucionet financiare vlerësojnë se “...për ta ruajtur Spanjën nga efektet shkatërruese të tregjeve financiare, në tri vitet e ardhshme do të nevojiteshin mbi 600 miliardë euro, shumë që as Spanja nuk e ka,

Problemet më urgjente janë “financimi dhe rikapitalizimi i bankave, çështjet e likuiditetit, dhe shërbimi i borxhit”.

dhe as vetë eurozona nuk mund t'ia akordojë". Nëpërmjet MES-it¹, Europa disponon në total 750 miliardë euro dhe nuk mund ta konsumojë mbi 80% të tij vetëm për Spanjën. Shpresa e vetme mbetet strategjia e "shpëtimin vetëm të sistemit bankar dhe rikapitalizimit të drejtpërdrejtë të bankave", i vlerësuar në rreth 100-150 dhe ndoshta deri në 200 miliardë euro, që mund të gjenden tek EFSF-ja², që zotëron tashmë mbi 450 miliardë euro, fond që mund të rikapitalizojë bankat nëpërmjet emetimit të obligacioneve, ashtu siç bëri në rastin e Greqisë. Realizimi i këtij skenari kërkon eliminimin e refuzimit gjerman. Spanja, për të shmangur "dorëzimin e sovranitetit financiar", duket se preferon një rikapitalizim të drejtpërdrejtë të bankave, pa kaluar nga mekanizmi i tutelës së gjithë sektorit bankar nga Brukseli, ndërkohë që Berlioni insiston se "as EFSF-ja dhe as MES-ja nuk janë të autorizuar që të kapitalizojnë drejtpërdrejt bankat". Për pasojë, "...kalimi nëpërmjet një enti publik garantues, për përdorimin e fondeve europiane është i detyrueshëm". Eurozona duket e gatshme që t'i përgjigjet pozitivisht kërkesës së qeverisë spanjolle, për t'i dhënë asaj një ndihmë prej 100 miliardë eurosh, e rishikueshme në një fazë të dytë, pas rezultateve të auditit të sektorit bankar. Pra, nuk pritet të ketë asnjë plan shtrëngues të ngjashëm me atë të Greqisë, Portugalisë apo Irlandës, por vetëm një angazhim të Madridit, për të zbatuar rigorozisht kushtet për sektorin e tij bankar. Qeveria spanjolle e vlerëson këtë gatishmëri të Eurogrup-it si një "fitore për besueshmërinë e euros", si një "shpërblim" për masat e jashtëzakonshme të Spanjës për reforma buxhetore e strukturore, në emër të stabilizimit të gjendjes.

Ndërsa Brukseli është i bindur se Spanja është angazhuar në reforma drastike strukturore dhe në masa shtrënguese buxhetore të jashtëzakonshme, tregjet financiare e kanë humbur besimin te qeveria Rajoy dhe "nuk bëjnë asnjë dhuratë për të", kur është fjala për përcaktimin e shifrave të nevojshme të rikapitalizimit bankar. Të gjithë duket se po presin rezultatet

përfundimtare të kabineteve të auditit Deloitte, KPMG, PwC, Ernst & Young, të cilat do të shifrojnë nevojat reale të sektorit bankar, të dobësuar së tepërmi nga ekspozimi në sektorin imobiliar; do të vlerësojnë shkallën e dobësimit të aktiveve bankare për çdo grup bankash, si dhe parashikimet për nevojat reale të tyre në muajt e ardhshëm. Ekspertët e vënë theksin te modeli i financimit dhe i kreditimit nga bankat, të cilat duke "kopjuar" modelin anglo-sakson të financimit, privilegjuan interesat tregtare në kurriz të standardeve të menaxhimit të rrezikut. Ato dhanë shumë kredi



imobiliare, pa u shqetësuar për aftësinë paguese të klientëve të tyre, duke stimuluar në këtë mënyrë një "filluskë të madhe imobiliare", shpërthimi i së cilës në vitin 2008, zhvlerësoi apo humbi shumë miliarda euro aktive "problematike" në bilancin e bankave spanjolle. Ndikim negativ dha edhe shkelja e çdo lloj disipline financiare dhe buxhetore nga pushtetet lokale, ose nga rajonet spanjolle, që hynë në borxhe kolosale duke u angazhuar në projekte faraonike, pa shumë eficiencë dhe vlerë për ekonominë e vendit.

Gjithçka filloi 4 vite më parë, kur çmimet e banesave filluan të bien me shpejtësi. Në vitet 2000-jë, rritja ekonomike e Spanjës u mbështet shumë te sektori i ndërtimit dhe periudha 2000-2008-të u cilësua si

"boom i ndërtimeve". Por në fund të kësaj periudhe, çmimet ranë 40-55%, ndërkohë që mbi 700,000 shtëpi u bllokuan, në pamundësi totale shitjeje. Menjëherë pas kësaj, shpërtheu papunësia, aq më tepër që 10-12% e fuqisë punëtore në Spanjë, ose rreth 2 milionë punonjës, ishte angazhuar në sektorin e ndërtimit (dyfishi i mesatares europiane). Kësaj tabloje iu shtua dhe legjislati aspak fleksibël i tregut të punës, që e vështirësoi akoma dhe më shumë ripërshtatjen dhe axhustimin e punësimit. Futja e Spanjës në zonën euro u shoqërua me një ulje drastike të kostos së kredisë, sepse ajo u lidh menjëherë me atë të vendeve të zhvilluara të eurozonës si: Gjermania, Franca, etj. Por gjithë ky fluks eurosh, me çmim të lirë, u përdor keq dhe u përqendrua pothuajse i gjithi në sektorin e ndërtimit. Në 2007-ën, Spanja ndërtoi 760,000 banesa, shifër kjo më e lartë se ndërtimet analoge në Francë, në Gjermani dhe në Itali, të marra sëbashku.

Sipas ekspertëve bankarë, "Bankia është pema që fsheh pyllin" e problemeve të vërteta të bankave spanjolle si: Santander, BBVA apo Caixa, ndërkohë që qeverisë spanjolle do t'i duhet të gjejë 150-200 miliardë euro për t'i rikapitalizuar ato, shifër kjo e barabartë me rreth 12-14% të PBB-sësë Spanjës. Përballë këtyre shifrave gjigante, qeveria spanjolle po bën një tërheqje të butë, duke deklaruar se "Spanja është gati që të dorëzojë një pjesë të sovranitetit të saj, veçanërisht në fushën buxhetore", në emër të "një autoriteti buxhetor europian, që do të ushtronte një kontroll të centralizuar të financave të vendit". E gjithë kjo, sipas kryeministrit spanjoll, mund të inkuadrohet në "reflektimet e Komisionit Europian për centralizimin e mbikëqyrjes bankare, për fondin e garancisë së depozitave dhe për krijimin e instrumenteve për kapitalizimin e drejtpërdrejtë të bankave europiane". Kësaj situatë kritike iu shtua dhe një faktor tjetër përkeqësues, ndërlidhja ndërmjet bankave të kursimeve dhe rajoneve të ndryshme të Spanjës, të cilat u kërkuar këtyre bankave të financonin programe gjigante për ndërtime shtëpish. E gjithë kjo "temperaturë ndërtimesh" çoi

1 Mekanizmi European i Stabilitetit.

2 Fondi European i Stabilitetit Financiar.



Ekonomia spanjolle duket se ka rezerva të brendshme, që e mposhtin frikën për një katastrofë të mundshme të saj. Sipas një raporti të bankës spanjolle BBVA, “që prej vitit 2008, Spanja e ka përmirësuar nivelin e konkurrueshmërisë dhe të produktivitetit të ekonomisë së saj shumë më tepër se vendet e BE-së”.

në bashkimin e shumë prej këtyre bankave të kursimit, siç është rasti i “Bankia”-s ku janë të grupuara 7 banka kursimesh. Vlerësohet se janë pikërisht këto lloj bankash ato që përbëjnë problemin e vërtetë të sektorit bankar spanjoll, pasi bankat e tjera të mëdha si: BBVA apo Santander, megjithëse janë të ekspozuara në rreth 180 miliardë euro aktive imobiliare problematike nga 340 miliardë euro në total, duken në një situatë relative më pak dramatike, pasi përqindja e kredive të këqija të tyre është rreth 7-8%.

Ekonomia spanjolle duket se ka rezerva të brendshme, që e mposhtin frikën për një katastrofë të mundshme të saj. Sipas një raporti të bankës spanjolle BBVA, “që prej vitit 2008, Spanja e ka përmirësuar nivelin e konkurrueshmërisë dhe të produktivitetit të ekonomisë së saj shumë më tepër se vendet e BE-së”. Produktiviteti për orë pune është rritur 8.3% gjatë gjithë këtyre viteve të krizës, ndërkohë që eksportet janë rritur 9.5%”. A mjafton kjo që Spanja ta ndiejë veten anash krizës dhe të

mos ketë frikë për përfshirjen në të? Shkaku kryesor që dyshimet ndaj ecurisë së dobët të sektorit bankar spanjoll sa vijnë e shtohen qëndron te planet e shumta të ndihmës që qeveria spanjolle nuk rresht së njoftuari, duke bërë që investuesit të mos besojnë më në cilësinë e tyre. Shumë prej ekspertëve të fushës vlerësojnë se “...larg të qenit maksimalisht alarmistë, shqetësimet për sektorin bankar spanjoll janë larg fundit. Lajme të tjera të këqija duken në horizont: kontraktimi i ekonomisë dhe hijet e recesionit janë vazhdimisht rrotull, tregu imobiliar vazhdon rënien, një pjesë e konsiderueshme depozitash po ikin nga Spanja, duke e përafëruar atë me skenarin grek, goditjet spekulative po shtohen, etj”. Shqetësimet vijnë dhe nga gjendja e borxhit të ndërmarrjeve dhe familjeve spanjolle. Sipas Bankës së Spanjës, borxhi i bizneseve dhe i familjeve spanjolle ka arritur në 218% të PBB-së dhe nën presionin e recesionit ekonomik, falimentimet dhe pamundësia e tyre për të shlyer huatë po shtohet frikshëm.

Eshtë koha për kartën tuaj të kreditit!



- **FALAS** për vitin e parë
- **Karta në dorën tuaj brenda 3 ditëve**
- **0%** për blerje në pikat e shitjes dhe Internet

Apliko ON LINE



Fibank
First Investment Bank

TELEFONONI PA PAGESË NË
0800 01 11

www.fibank.al

ALPHA BANK



ALPHA BANK organizon "Ditën e vullnetarizmit Alpha Bank"

Më 27 maj, 2012, Alpha Bank organizoi për të katërtin vit radhazi "Ditën e vullnetarizmit Alpha Bank". Vitin e kaluar punonjësit e Alpha Bank Albania vizituan "Shtëpinë e të moshuarve" në Tiranë dhe kontribuan për përbushjen e nevojave më të ngutshme të këtij azili.

Këtë vit, Alpha Bank ndihmoi 100 familje në nevojë në Tiranë. Punonjësit e saj vizituan Qendrën Sociale "Të qëndrojmë së bashku", në Kombinat, dhe shpërndanë paketa ushqimore për këto familje. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Lulzim Basha.

Drejtori i Përgjithshëm, z. Periklis Drougkas, deklaroi se përgjegjshmëria sociale është shumë e rëndësishme për Alpha Bank-ën. Ai tha se "Në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës ne informohemi mbi projektet e saj, të cilat janë në përputhje me vlerat, me parimet dhe me aktivitetet e Grupit të Alpha Bank-ës dhe i mbështesim ato".

BKT

BKT në mbështetje të jetimëve shqiptarë

BKT, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Integritimit të Jetimëve Shqiptarë, ka mbështetur aktivitetin e zhvilluar më 20 maj, që është Dita Kombëtare e Jetimëve në Shqipëri. Në aktivitet mori pjesë dhe ambasadori i OSBE-së në Tiranë, z. Eugen Wollfarth. Në aktivitet u bë apel për më shumë kujdes për fëmijët jetimë dhe për mbrojtjen e të drejtave të tyre, sepse ata janë një shtresë e shoqërisë që ka nevojë për përkrahje dhe për dashuri.



EMPORIKI BANK



BANKA EMPORIKI SHQIPËRI ndan dhurata për fëmijët jetimë në ditën e 1 Qershorit

Në 1 Qershor, Ditën e Fëmijëve, Banka Emporiki Shqipëri – Crédit Agricole Group, ishte pranë fëmijëve jetimë në Tiranë dhe në Durrës. Në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Banka përqafoi iniciativën e 30 kompanive, të cilat kontribuan me ndihma dhe dhurata për fëmijët e fshatit SOS në Tiranë.

Gjatë kësaj dite, një tjetër aktivitet u organizua në mjediset e Shtëpisë së Foshnjës të qytetit të Durrësit, ku përfaqësues të kësaj Banke shpërndanë dhurata për të gjithë fëmijët e këtij institucioni. Këto evente përforcojnë qëndrimin e Bankës Emporiki Shqipëri si pjesë e Crédit Agricole Group gjithmonë në anën e komunitetit duke i kushtuar rendësi të veçantë impaktit social në aktivitetin e saj.

INTESA SAN PAOLO BANK



Shqiptarët për njëri-tjetrin, ndihmë sociale për fëmijët jetimë dhe familjet në nevojë

Në bashkëpunim me Fondacionin e "Qatarit" në Shqipëri Intesa Sanpaolo Bank Albania mori pjesë në nismën "Shqiptarët për njëri-tjetrin", ku u përfshi një pjesë e madhe e stafit të Bankës. Ata grumbulluan për fëmijët jetimë dhe familjet në nevojë një sasi të konsiderueshme rrobash, këpucësh, lodrash e librash. Këto ndihma, bashkë me një shumë modeste të hollash, të dhuruara nga punonjësit e kësaj dege, u dorëzuan për Fondacionin "Qatari" nga drejtori i Degës së Bankës, që ndodhet në Rrugën e Durrësit, z. Gramos Osmani.

Banka gjithashtu mbështeti festën e 1 Qershorit për fëmijët jetimë, organizuar nga Fondacioni i "Qatarit", ku mori pjesë edhe Drejtori i Retail-it, z. Alberto Prestopino.

Dita Ndërkombëtare e Mjedisit 5 qershor 2012

Me rastin e ditës ndërkombëtare të mjedisit, në 5 qershor 2012, nën sloganin "Ekonomia e Gjelbërt, a ju përfshin dhe ju?" Banka ndërmoi një fushatë ndërgjegjësimi për punonjësit dhe klientët nëpërmjet posterave të vendosura në mjediset e Bankës, në faqen e internetit dhe nëpërmjet mesazheve senibilizuese në ekranet e bankomatëve. Kjo nismë iu bashkua iniciativave të të gjitha bankave të Grupit Intesa Sanpaolo, që këtë vit mori çmimin ndërkombëtar nga klasifikimi i Bloomberg-it si Banka më "E gjelbër" në Itali dhe Banka e Tretë më e "E gjelbër" në Botë, për politikën e saj të qëndrueshme mjedisore dhe investimet në fushën e energjisë së rinovueshme, në përputhshmëri të plotë me dispozitat ligjore për mjedisin.



NBG

NBG Albania feston me fëmijët 1 Qershorin

Me moton "Nuk është asnjëherë herët për të investuar në të ardhmen e fëmijës suaj", NBG Bank Albania zhvilloi një aktivitet festiv për 1 Qershorin. Të ftuarit e veçantë të aktivitetit ishin fëmijët e Tiranës, për të cilët u përgatit një shfaqje me lojra dhe këngë. Aktiviteti në rrugën Murat Toptani në kryeqytet u realizua edhe falë mbështetjes nga Bashkia e Tiranës.

Drejtori i Përgjithshëm i NBG Albania, Ioannis Kougionas, shprehu kënaqësinë e veçantë që të festojë mes fëmijëve këtë ditë dhe premtori mbështetje të vazhdueshme për ta.

NBG Albania i kushton shumë vëmendje fëmijëve nëpërmjet programeve të veçanta, si të ndihmës për fëmijët në nevojë, ashtu edhe përmes produkteve që synojnë promovimin e kursimit për të ardhmen e tyre qysh në moshë të vogël.



CREDINS BANK

Credins Bank në vazhden e përgjegjësisë sociale dhe filantropisë, prej kohësh mbështet fshatin SOS. Më 26 Qershor 2012, ditën e kushtuar donatorëve të këtij institucioni që kujdeset për fëmijët në nevojë, Credins Bank, si një formë e bukur vlerësimi dhe mbështetje për talentet e vegjël, mori pjesë në ankandin e organizuar të shitjes së pikturave të tyre.



PROCREDIT BANK



Edukimi i Fëmijëve - investim për të ardhmen e Komunitetit

Aktivitete të shumta u zhvilluan në çdo degë të ProCredit Bank me rastin e Festës së Fëmijëve - 1 Qershorit. Punonjësit e degëve i mirëpritën grupet e fëmijëve, të shoqëruar nga prindërit e tyre, me lojëra, muzikë, libra e dhurata. Në këto festa figura qendrore ishte Ketri ProKid, simboli i llogarisë së kursimit për fëmijë.

Banka ndihet pjesë integrale e komuniteteve ku operon dhe cilësia e jetesës së komunitetit është e rëndësishme për të. Një sërë politikash e programesh zhvillimi, në mbështetje të arsimit publik, moshës së tretë, fëmijëve pa prindër, ose me aftësi të kufizuara, kanë ndihmuar në vite këto komunitete nëpërmjet programeve të "Fqinjësisë" apo "Neighbourhood-it".

Gjithashtu, Dega e ProCredit në Vlorë mbështeti një aktivitet sa origjinal, aq edhe argëtues, të quajtur "Festa e akullores" për fëmijët e "Shtëpisë së fëmijës" së qytetit. Një konkurs me punimet më të mira në pikturë u organizua për ta si dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara.

RAIFFEISEN BANK

RAIFFEISEN BANK ndihmon për transportin për në Austri të dy vajzave të plagosura

Raiffeisen Bank u ofroi institucioneve shëndetësore mbështetje financiare për transportin e dy vajzave, në gjendje kritike, të plagosura në aksidentin tragjik që ndodhi në muajin maj në Himarë. Raiffeisen Bank dha kontributin e saj financiar për transportimin e tyre për ndihmë më të specializuar në një prej spitaleve të Austrisë.

"Unë do të jem shumë i lumtur të shtrëngoj duart me to kur të kthehen nga Austria", tha z. Christian Canacaris, Drejtor i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank në Shqipëri. Ky kontribut ishte një shënjë solidariteti me njerëzit, me institucionet dhe veçanërisht me Ministrinë e Shëndetësisë, që bëri të pamundurën për të ndihmuar këto vajza.



TIRANA BANK

TIRANA BANK merr pjesë në Konferencën rajonale për CSR (Corporate Social Responsibility)

Më 5 qershor të 2012-ës u zhvillua Konferenca mbi "Zhvillimin e përgjegjshmërisë sociale - Sfidat dhe praktikat në rajon", me përfaqësues të sektorit të biznesit, institucioneve qeveritare, shoqërisë civile si dhe medieve në Shqipëri, në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Tirana Bank ishte përfaqësuesja e vetme e industrisë bankare në Shqipëri.

Prezantimi që mbajti znj. Frida Krifca, Drejtore e Departamentit të Marketingut dhe PR mbuloi sfidat që mbartin veprimtaritë CSR, por dhe solli në vëmendje aktivitetet CSR të Piraeus Bank Group, si rastet e "Bankingut të Gjellbër" dhe nisma për automjetet hibride të padëmshme ndaj mjedisit, që pasqyrojnë kulturën e përbashkët të grupit. Tirana Bank prezantoi disa projekte CSR si: mbështetje për edukimin e fëmijëve, dhurimi i gjakut (nisma e Kryqit të Kuq), dhe kujdesin ndaj mjedisit (inkurajimi për qytete të pastra).

Kjo Konferencë, e para në llojin e vet, ishte shumë e rëndësishme në kuadrin e prezantimit të fazës aktuale "fillestare" në të cilën gjendet rajoni si dhe nxitjen për të zhvilluar përgjegjshmërinë sociale në Shqipëri dhe më gjërë.



SOCIETE GENERALE ALBANIA



Sponsorizim në Shkodër

SGAL në kuadrin e ditës së Europës dhe përgjegjësisë sociale mbështeti aktivitetin për nxitjen e talenteve të reja të futbollit zhvilluar në Shkodër më 9 maj, 2012. Aktiviteti u organizua në partneritet me Bashkinë Shkodër dhe me FSHF-në dhe me mbështetjen e Qendrës së Informimit të BE-së në Shkodër. Aktiviteti u ndoq nga rreth 2000 persona, të rinj nga shkollat e qytetit, kalimtarë si dhe frekuentues të lokaleve në këtë zonë. Fituesit të vendit të parë iu dha nga SGAL një çmim prej 50,000 lekësh.



Sponsorizim në fshatin e fëmijëve "SOS" Tirana.

Societe Generale Albania sponsorizoi organizimin e aktivitetit në fshatin e fëmijëve "SOS" më 26 qershor, 2012. Në këtë ditë të veçantë, fshati i fëmijëve "SOS" organizoi një shitje në ankand të pikturave të cilat ishin pikturuar nga vetë fëmijët. Fëmijët i prezantuan dhe i komentuan vetë pikturat, ndërkohë që pjesëmarrësit i blinin ato. Gjatë këtij aktiviteti SGAL bleu tri piktura të fëmijëve.

UNION BANK

UNION BANK mbështet Festivalin e Fëmijëve "Fest 2012" Kukës

Në vitin e 100 Vjetorit të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar, Union Bank mbështet aktivitetet kulturore dhe artistike rajonale. Union Bank ka mbështetur Festivalin e Fëmijëve "Fest 2012" Kukës, organizuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale – Kukës. Festivali u zhvillua gjatë periudhës 31 maj – 4 qershor, 2012 në qytetin e Kukësit, me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe nxënësve të shkollave të Qarkut Kukës. Union Bank vlerësoi punën dhe angazhimin e artistëve, krijuesve dhe instrumentistëve të Festivalit përmes dhënies së çmimeve për fituesit e Festivalit "Fest 2012".



VENETO BANKA



Veneto Banka ka mbështetur Qendrën Sociale "Murialdo", një qendër edukimi për të rinjtë. "Murialdo" funksionon në dy qytete, në Durrës dhe në Fier. Ajo organizon kurse profesionale për përvetësimin e profesioneve të ndryshme, mjaft të nevojshme për të rinjtë e komuniteteve, kryesisht në zonat rurale. Kjo është një qendër italiane me eksperiencë mjaft të gjerë në pothuajse gjithë Italinë. Veneto Banka do të vazhdojë të mbështesë këtë qendër edhe në të ardhmen.

LAJME NDËRBALLKANIKE

BOSNJE HERCEGOVINA



Banka Ziraat e Turqisë i siguron linjë kreditimi 100 milion Euro Bosnje Hercegovinës

BNE - 17 maj 2012

Turqia ra dakord të ofrojë nëpërmjet Bankës Turke Ziraat një linjë kreditimi prej 100 milion Euro për mbështetjen e zhvillimit të ekonomisë së Bosnje Hercegovinës. Ndihma do të kalojë përmes Bankës Turke Ziraat në Bosnje dhe Bankës Ndërkombëtare të Bosnjës, që do të marrin nga 50 milionë euro secila. Ky fond do të përdoret për financimin e investimeve në bujqësi dhe turizëm, për të rritur punësimin nëpërmjet SME-ve dhe mikrokredivë. Linja e kreditimit synon të mbështesë edhe kthimin e qëndrueshëm të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit.

Spektori bankar i Bosnje Hercegovinës i fortë dhe i qëndrueshëm

Balkans.com - 21 maj 2012

Gubernatori i Bankës Qendrore të Bosnjes (CBBiH) Kemal Kozariç, deklaroi në panelin e organizuar për sektorin financiar në Forumin e Biznesit të Sarajevës (SBF) se, sektori bankar në BiH është i shëndetshëm dhe monedha vendase e qëndrueshme. "Spektori bankar në BiH është i fortë dhe i shëndetshëm dhe një partner i mirë për investitorët potencialë të BiH", tha Kozariç. Ai theksoi se bankat duhet të synojnë likuiditetin dhe të arrijnë rikapitalizimin e mjaftueshëm. Ai përmendi se BiH ka 29 banka tregtare dhe pesë prej tyre kontrollojnë 70% të tregut.

BULLGARIA



Bankat vazhdojnë të shlyejnë borxhin e huaj

FOCUS News - 27 prill 2012

Investor.bg informon se bankat bullgare kanë shlyer 105.8 milionë euro të borxhit të tyre të huaj në shkurt të vitit 2012 dhe një total prej 1.14 miliardë dollarë për 12 muajt e fundit. Pothuajse gjithë rënia e borxhit të jashtëm bruto u



mundësua nga shlyerjet e institucioneve financiare. Deri më 29 shkurt 2012 borxhi i bankave ishte rreth 5.48 miliardë euro, ndërsa borxhi i jashtëm bruto arriti në 35.08 miliardë euro. Bankat shlyejnë borxhet pasi nuk gjejnë projekte cilësore për t'i financuar në Bullgari, si pasojë e kriterëve të tyre apo mungesës së kërkesës së personave fizikë dhe juridikë për hua.

Huatë me probleme në Bullgari mbulohen nga rezervat

Standart - 11 maj 2012

"Përqindja e huave me probleme në Bullgari nuk duhet të jetë shqetësim i qytetarëve, pasi sistemi bankar bullgar ka një mburojë të mjaftueshme", deklaroi guvernatori i Bankës Kombëtare Bullgare (BNB) Ivan Iskrov, në një forum shkencor mbi sfidat e ekonomisë.

Sipas të dhënave të BNB-së, kreditë e këqija arrijnë në 16%, por sipas z. Iskrov, kjo është vetëm 10% e huave, nëse zbriten provigjionet. Analiza e BNB-së tregon se rritja ekonomike në Bullgari për vitin 2012 do të jetë rreth 0.7%, por nuk përjashtohet që gjatë vitit të ketë ndonjë korigjim të kësaj shifre. Parashikimi i fundit i Ministrisë së Financave është për një rritje ekonomike prej 1.4%. Guvernatori i BNB-së rekomandon se duhen zgjidhje afatgjata për zhvillimin e ekonomisë së Bullgarisë.

KROACIA



Banka Qendrore e Kroacisë ul normën e rezervës së detyrueshme për bankat në 13.5%

BNE - 12 prill 2012

Në deklaratën pas një mbledhje bordi, theksohet se Banka Qendrore e Kroacisë redukton normën e saj të rezervës së detyrueshme për bankat tregtare në 13.5% nga 15%. Në deklaratë thuhet se ky veprim u ndërмор për të zhbllokuar më shumë se 4 miliardë HRK (534 milionë euro) likuiditet, për nxitjen e huadhënies ndaj sektorit të korporatave, njofton Reuters. Banka qendrore synon të nxisë rimëkëmbjen ekonomike pas tre viteve recesion. Ajo shprehet se bankat do të ofrojnë hua të reja veçanërisht për firmat eksportuese. Banka qendrore u ka kërkuar gjithashtu bankave tregtare ta kthejnë shumën e zhbllokuar në fonde të reja në dispozicion të huadhënies, çka nuk duhet të jetë pengesë pasi likuiditeti në sektorin bankar gjatë muajve të fundit ka qenë i lartë.

Fitimet bankare rriten me 12%

CROATIAN TIMES - 07 maj 2012

E përditëshmjia 24 Sata raporton se fitimet totale të bankave kroate arritën në 3.73 miliardë kuna (497,7 miliardë euro) në tremujorin e parë të vitit 2011, një rritje prej 11.9% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Njëkohësisht kreditimi bankar u rrit me 0.8%, ndërsa totali i depozitave në bankë dhe llogaritë rrjedhëse ranë me 13.8% krahasuar me fundin e vitit të kaluar. Kursimet ranë 6%, dhe depozitat me afat u rritën 2.6%. Sipas raporteve të Bankës Kombëtare Kroate (HNB), totali i depozitave ra me 0.5%.

GREQIA



Credit Agricole do të marrë nën kontroll aktivet në Bullgari, Rumani dhe Shqipëri nga dega greke e saj, Banka Emporiki

BNE - 18 qershor 2012

Sipas një deklaratë më 15 qershor, Banka franceze Credit Agricole ka marrë nga filiali i saj grek, Banka Emporiki, kontrollin e aktiveve në Bullgari, Rumani dhe Shqipëri. "Ky transaksion brenda grupit është hapi i fundit i një procesi të zhvilluar që nga fillimi i vitit 2009 për të përforcuar lidhjet midis Credit Agricole SA dhe filialeve të Grupit Emporiki", citon Novinite të ketë thënë Emporiki. "Kjo marrëveshje do të lejojë që Emporiki të racionalizojë më tej strukturën e korporatës dhe përforcojë përpjekjet për të përballuar me efektivitet situatën dhe sfidat aktuale.

Greqia u dorëzoi 18 miliard euro katër bankave të saj më të mëdha.

CNBC - 29 maj 2012

Greqia u dorëzoi 18 miliard euro (22,6 miliardë USD) katër bankave të saj më të mëdha, duke u ridhënë huadhënësve të prekur nga kriza qasje për financim pranë Bankës Qendrore Europiane. Injektimi nëpërmjet bonove nga fondi i shpëtimit i Mbështetjes Europiane për Stabilitet Financiar do të rrisë bazën e kapitalit të katër bankave: National Bank, Alpha, Eurobank dhe Piraeus. Një punonjës pranë Hellenic Financial Stability Facility tha për Reuters se "Fondet janë shpërndarë." HFSF u krijua për kanalizimin e fondeve nga programi i ndihmës për Greqinë, për rikapitalizimin e bankave të saj. HFSF ka alokuar 6.9 miliard euro për NBG, 1.9 miliard për Alpha Bank, 4.2 miliard euro për Eurobank dhe 5 miliard euro për Piraeus.

KOSOVA



Thellohet bashkëpunimi bankar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë

11 qershor 2012

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) dhe Banka e Shqipërisë kanë ripërtërirë Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, ku ndër fushat e reja të bashkëpunimit do të jetë projekti i përbashkët për edukimin financiar të publikut.

Duke vlerësuar lartë bashkëpunimin e deritanishëm, Guvernatori Gërguri dhe Guvernatori Fullani, shprehën gatishmërinë e lartë për të thelluar bashkëpunimin midis dy bankave qendrore duke qenë të bindur se ky bashkëpunim do të kontribuojë në realizimin sa më efektiv dhe më efikas të objektivave të dy institucioneve.

MALI I ZI



Pesë banka në Malin e Zi regjistrojnë rezultate negative tremujorin e parë

BNE - 12 qershor 2012

Rezultatet financiare të tremujorit të parë për sektorin bankar të Malit të Zi, ishin negative për pesë banka dhe pozitive për gjashtë prej tyre. Shoqata e Bankave Malazeze vëren se, humbja arriti në 6.6 milion euro krahasuar me rezultatin negativ të së njëjtës periudhë të vitit 2011, prej 17.5 milion euro. Rezultatet tremujore u karakterizuan nga prirja pozitive, veçanërisht rritje të bilancit, kredive dhe depozitave. "Raporti i huave ndaj depozitave është përmirësuar, ndërsa aktivet dhe huatë me probleme kanë pësuar rënie", thekson Shoqata, duke shtuar se normat e interesit, aktive dhe pasive, patën rënie të lehtë.

MAQEDONIA



BERZH i jep Bankës ProCredit të Maqedonisë hua në denarë në vlerën 5 milionë euro

BERZH - 04 prill 2012

BERZH po rrit disponueshmërinë e financimit të bizneseve private në IRJ të Maqedonisë me një hua në monedhë lokale në shumën ekuivalente me 5 milionë euro për Bankën ProCredit në Maqedoni për huadhënie ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). Huaja kalon nëpërmjet EBRD-Italy Local Enterprise Facility dhe do të ndihmojë bazën e financimit dhe të vazhdojë kreditimin e NMVM në mjedisin sfidues aktual.

Sistemi bankar i IRJ të Maqedonisë mbetet i qëndrueshëm

Balkans.com - 23 maj 2012

Sistemi bankar i Maqedonisë mbeti stabil, duke ruajtur aftësi paguese dhe likuiditet të lartë, pavarësisht pasigurisë së krizës së borxhit në BE. Stres-testet kanë treguar se bankat e IRJ të Maqedonisë mund të përballojnë edhe skenarët më të vështirë, konkludoi Komisioni i Stabilitetit Financiar, që shqyrtoi të Martën tendencat e fundit në sistemin bankar të vendit. "Sistemi bankar i IRJ të Maqedonisë tregon stabilitet të jashtëzakonshëm. Mjaftueshmëria e kapitalit është rritur me 17.5%, ndërsa aktivet me likuiditet të lartë në totalin e aktiveve të sistemit bankar arritën në 31.5% tremujorin e parë të vitit 2012", tha Dimitar Bogov, Guvernatori i Bankës Kombëtare të Maqedonisë (BPRM).

RUMANIA



Tregu i huave konsumatore në Rumani u rrit me 10% vitin e kaluar

BUSINESS REVIEW - 12 Prill 2012

Tregu i huave konsumatore në Rumani u rrit me 10%, në 469 milion Euro vitin e kaluar, sipas të dhënave nga Shoqata e Kompanive Financiare - ALB Rumania. Cetelem IFN, firmë e huasë konsumatore, pjesë e BNP Paribas Personal Finance, vlerëson se tregu i huasë konsumatore do të rritet me 5% këtë vit. Cetelem është firma e parë e huasë konsumatore në Rumani që raporton një rritje prej 24% në vëllimin e huasë gjatë vitit të kaluar.

Banka Qendrore e Rumanisë lehtëson procedurat për dhënie likuiditeti bankave tregtare

BLOOMBERG - 01 qershor 2012

Banka qendrore e Rumanisë lehtësoi procedurat për dhënie likuiditeti bankave tregtare, duke iu dhënë huadhënësve mundësinë të vendosin më shumë para në këmbim të letrave me vlerë të shtetit. Sipas një dokumenti publikuar

në faqen e internetit të Autoritetit, politikëbërësit rritën numrin e titujve të borxhit shtetëror që një bankë mund të përdorë si kolateral për të marrë likuiditet nga banka qendrore, nga tre në pesë, duke përfshirë edhe operacionet e riblerjes javore. Disa nga 41 bankat që operojnë në tregun rumun, me pronësi kryesisht nga Europa Perëndimore, kanë filluar të mbështeten më shumë në financimin nga banka qendrore pasi përkeqësimi i krizës Europiane të borxhit ka reduktuar financimin nga bankat mëmë.

SERBIA



Sistemi bankar i Serbisë një nga më të qëndrueshmit në rajon

Balkans.com - 28 maj 2012

Banka Kombëtare e Serbisë po monitoron nga afër situatën në sistemin bankar dhe financiar të vendit dhe nuk vhen re prirja që mund të cilësohen si destabilizuese, tha Guvernatori Dejan Soskic. Ai theksoi se nuk ka arsye për shqetësim pasi bankat lokale janë mjaft të kapitalizuara dhe likuide. Kursimet në monedhë të huaj të qytetarëve jo vetëm që sigurohen nga shteti deri në nivelin e 50,000 eurove për depozitë kursimi, por niveli relativisht i lartë i rezervave valutore të detyrueshme përbën një garanci shtesë jo vetëm për likuiditetin, por edhe për aftësinë paguese të bankave që mbajnë depozitat e qytetarëve, shpjegoi Soskic.

TURQIA



Citigroup po shet 10.1% të aksioneve të saj në bankën turke Akbank TAS

SFGate - 25 maj 2012

Citigroup Inc. po shet 10.1% të aksioneve të saj në bankën turke Akbank TAS, me vlerë 1.27 miliardë dollarë, pasi banka e tretë sipas aktiveve në SHBA po shton kapitalin. Sipas Bloomberg, banka me bazë në Nju Jork ofron për investitorët 404 milion aksione në Akbank, pronë e Citigroup Overseas Investment Corporation, me vlerë 5.20 deri 5.30 Lira secila.

Banka për Zhvillim e Turqisë nënshkroi marrëveshje huaje prej 75 mln euro me BEI

Balkans Business - 11 maj 2012

Banka për Zhvillim e Turqisë (DBT) nënshkroi marrëveshje huaje prej 75 milionë Euro me Bankën Europiane të Investimeve (BEI) për "Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mëdha (Kredi e DBT për Energji të Rinovueshme dhe Produktivitet Energjie)." DBT ka bashkëpunuar me BEI që prej vitit 2002 dhe ka siguruar prej saj 462.5 milionë euro kredi, njoftoi raportuesi i së përditshmes Hurriyet.



Vlerësojmë mbështetjen tuaj

Dega Toptani dhe Head Office

Rruga "Murat Toptani"

(Eurocol Center)

Tirane Albania

Tel: 4 2256 254 / 2254 372 / 2235 406

Fax: 4 2235 409 / 2254 368

Email: toptani@icbank-albania.com

Themeli i një sipërmarrje është besimi. Për 15 vite, ju, klientët tanë keni besuar në vizionin tonë për vlerat bankare. Ambicja dhe angazhimi ynë në vlera të shkëlqyera bankare bazohet në parimet e Besimit, Përballueshmërisë, Thjeshtësisë dhe Transparencës. Vlerësojmë mbështetjen tuaj duke drejtuar sipërmarrjen tonë me integritet dhe profesionalizëm dhe do të vazhdojmë të ndjekim vizionin e vlerave bankare duke krijuar platforma me produkte dhe shërbime, të cilat vendosin ju, klientët tanë, në plan të parë





nga Prof. Dr. Petraq PAPAJORGI
Pedagog, UET & Kryeredaktor
i "International Journal of
Agricultural & Environmental
Information Systems"

Në shumicën e rasteve, bankave në Shqipëri u janë dhënë programe kompjuterike nga institucionet e tyre të origjinës dhe për këtë arsye ato kanë sisteme informacioni franceze, britanike, etj. Fillimisht, kjo ishte një zgjidhje e pashmangshme, sepse bankat të ne nuk kishin ndonjë model biznesi, ose ndonjë sistem informacioni që t'u përshtatej kushteve tona. Zbatimi i një modeli të huaj ishte e vetmja mënyrë për të pasur një bankë funksionale me standarde të pranueshme. Është e vërtetë që zbatimi i një sistemi të huaj informacioni ofron një zgjidhje të shpejtë si pikënisje, por me kalimin e kohës lindin disa probleme që duhet të trajtohen sa më shpejt të jetë e mundur. Sipas mendimit tim modest, një bankë në Tiranë nuk funksionon dhe nuk duhet të funksionojë në të njëjtën mënyrë si një bankë në Londër, në Nju Jork, në Paris, etj. Produktet bankare janë të lidhura ngushtësisht me ekonominë e një vendi dhe në një masë të caktuar edhe me mentalitetin e tij.

Në këtë kontekst, unë mendoj se është e rëndësishme që bankat tona të fillojnë të mendojnë për zhvillimin e modelit të tyre të biznesit për menaxhimin e bankës. Kjo nuk do të thotë të anashkalohet ekspertiza e huaj,

RËNDËSIA E MODELIMIT NË SEKTORIN BANKAR

Bankat e ndryshojnë modelin e tyre të biznesit për të filluar procese të reja, ose për të modifikuar proceset ekzistuese, me qëllim që të mbijetojnë në një treg konkurrues dhe të përmbushin më mirë nevojat e klientëve.

shumë e vlefshme, por të hidhet hapi i parë drejt një procesi që kombinon përvojën e huaj me nevojat tona specifike.

Një hap i parë në këtë drejtim është rishikimi i programeve të lëndëve të departamenteve të ekonomiksit dhe financës për t'u siguruar që specialistëve të ardhshëm bankarë do t'u mësohen temat e duhura. Mendojmë se tema të tilla nuk janë bërë ende pjesë e kurrikulës që zhvillohet në universitetet tona. Është e nevojshme të hyjnë lëndë të reja si Modelim Biznesi, Modelim i Procesit të Biznesit, Modelim Simulimi dhe lëndë të tjera të ngjashme. Le të hedhim një vështrim më të detajuar mbi atë çka përmbajnë këto lëndë dhe pse është e rëndësishme që ato të jenë pjesë e kurrikulës të universiteteve tona.

Sipas Wikipedias, modeli i biznesit përshkruan një sërë arsyesh mbi bazën e të cilave një organizatë krijon, përcjell, dhe fiton vlerë (ekonomike, sociale, etj.). Modelimi i biznesit është një mjet i rëndësishëm për të kontrolluar, dizenuar, përtërirë dhe transformuar biznesin. Modeli i biznesit nuk duhet të konsiderohet si një aktivitet i veçantë, por i lidhur ngushtë me sistemin e informacionit bankar. Kjo lidhje është shumë e rëndësishme dhe tek ajo duhet të përqendrohet menaxhimi i bankës gjatë gjithë kohës. Sistemi i informacionit dhe modeli i biznesit në sektorin bankar hartohen, zhvillohen dhe mirëmbahen nga grupe të ndryshme njerëzish. Modeli i biznesit hartohet

nga një ekip strategësh, ekonomistësh, parashikuesish dhe personash të tjerë, të cilët vendosin mbi natyrën e aktiviteteve që një bankë duhet të ndërmarrë për të dalë me fitim. Sistemi i informacionit hartohet kryesisht nga inxhinierët e programeve kompjuterike të cilët marrin parasysh edhe vlerësimet profesionale të kontabilistëve, ekspertëve të tregut, etj, për të hartuar një sistem që regjistron të gjitha transaksionet e mundshme bankare, sipas një modeli të mirëpërcaktuar biznesi. Fillimisht, modeli i biznesit dhe sistemi i informacionit hartohen për të mbështetur njëri-tjetrin. Është e kuptueshme që modeli i biznesit është ai që dikton funksionet e sistemit të informacionit.

Edhe pse këto dy pjesë të ndryshme dhe të rëndësishme të bankës

Modeli i biznesit hartohet nga një ekip strategësh, ekonomistësh, parashikuesish dhe personash të tjerë të cilët vendosin mbi natyrën e aktiviteteve që një bankë duhet të ndërmarrë për të dalë me fitim.



... teknologjia mund të ndikojë fuqishëm në modelin e biznesit, çka do të thotë se ekipi i specialistëve që hartojnë dhe mirëmbajnë modelin e biznesit duhet të jetë në kontakt me risitë në sektorin e teknologjisë.

kanë të njëjtën pikë nisjeje, me kalimin e kohës ato natyrisht ndryshojnë. Bankat ndryshojnë modelin e tyre të biznesit për të futur procese të reja, apo për të modifikuar proceset ekzistuese me qëllim që të mbijetojnë në një treg konkurrues dhe të përmbushin më mirë nevojat e klientëve, etj. Sistemit të informacionit i duhet kohë për të bërë modifikimet e nevojshme për t'iu përshtatur ndryshimeve të modelit të biznesit. Ndërkohë, si pasojë e "inercisë" së sistemit të informacionit, mund të ndodhë që disa transaksione të mos regjistrohen duke krijuar kështu "boshllëk informacioni". Kjo situatë mund të krijojë probleme serioze pasi disa operacione bankare mund të mos llogariten dhe për këtë arsye, menaxhimi i bankës mund të hasë vështirësi në vlerësimin e një pjese të aktiviteteve të saj. Kështu, është e nevojshme të ketë jo vetëm një model biznesi të studiuar mirë, por edhe një qasje për hartimin dhe modifikimin e sistemit informativ të bankës sa herë ka ndryshim të modelit të biznesit. Është me vend të theksohet se kjo qasje duhet të nxitet nga modeli, pasi modeli i biznesit është forca lëvizëse e bankës.

Përshtatja e modelit të biznesit me sistemin përkatës të informacionit, nuk është një çështje që i takon vetëm sektorit bankar, por të gjitha llojeve të ndërmarrjeve. Industria e softuerëve i është përgjigjur këtij problemi duke ofruar një qasje sipas modelit

për ngritjen e softuerit. Nisma më e rëndësishme në këtë drejtim është Arkitektura e Mbështetur mbi Modelin (MDA). MDA është një qasje e dizenjimit të softuerit për zhvillimin e sistemeve softuer. Ajo përmban një paketë udhëzimesh për strukturimin e specifikimeve të cilat shprehen si modele. Arkitektura e mbështetur mbi modelin është një lloj inxhinierie e fushës dhe mbështet inxhinierinë e sistemeve softuer që bazohet mbi modelin. Ajo u lançua në vitin 2001 nga Object Management Group (OMG). Qasja MDA përkufizon funksionalitetin e sistemit duke përdorur një model pa platformë (PIM) dhe Gjuhën e Unifikuar të Modelimit (UML). Në një fazë të mëvonshme, ky PIM shndërrohet në një model me platformë specifike (PSM), i cili merr në konsideratë specifikat e platformës kompjuterike. Kështu, një PIM mund të përkthehet në disa PSM; kjo do të thotë se i njëjti model biznesi, i shprehur në UML, mund të konvertohet në platforma të ndryshme kompjuterike/informative, duke marrë parasysh specifikat e harduerit që mund të jenë të ndryshme në institucione të ndryshme. Me fjalë të tjera, fakti që banka përdor teknologjinë Oracle dhe/ose NET, ose ndonjë teknologji tjetër për atë çështje, nuk ndikon aspak në modelin e biznesit. Në qasjen MDA kodi i sistemit merret nga modeli; sa herë që ndryshon modeli duhet të ndryshojë edhe kodi,

por do të ishte i pakuptimtë ndryshimi i kodit, pasi kodi është rezultat i modelit.

Nga ana tjetër, teknologjia mund të ndikojë fuqishëm në modelin e biznesit, çka do të thotë se ekipi i specialistëve që hartojnë dhe mirëmbajnë modelin e biznesit duhet të jetë në kontakt me risitë në sektorin e teknologjisë. Për shembull, modeli i biznesit në shekullin XXI duhet të marrë në konsideratë kapacitetet e Web 2.0, të tilla si inteligjenca kolektive, efektet e rrjetit, përmbajtjen e gjeneruar nga përdoruesit dhe mundësinë për sisteme vetëpërmirësuese. Sot, është e pakonceptshme që klientëve të bankave të mos u ofrohet mundësia e kontrollit të llogarive të tyre "on line", një tipar jo i zakonshëm në sistemin tonë bankar. Për më tepër, për shkak të përdorimit të zakonshëm të euros në tregun tonë, bankat duhet t'iu ofrojnë klientëve të tyre mundësinë për të kontrolluar llogaritë e tyre të ndryshme për valuta të ndryshme.

Si përfundim, praktikat më të mira sugjerojnë krijimin e ekipeve të modeluesve, detyra e të cilëve duhet të jetë të kuptuarit dhe të zhvilluarit e mëtejshëm të modelit të biznesit të inkuorporuar në sistemin informativ të bankës. Shumë shpejt, bankave mund t'iu kërkohet të bëjnë ndryshime në sistemin e tyre të informacionit si rezultat i ndryshimeve që ndodhin në modelet e tyre të biznesit.

KULTURA EKONOMIKE DHE LIDHJA ME SHËRBIMET DHE PRODUKTET BANKARE NË SHQIPËRI



Dokt. Arbi AGALLIU
Pedagog
Universiteti Europian i Tiranës

Sistemi bankar shqiptar është një sistem i ri, krahasuar me sistemet bankare të vendeve të zhvilluara, dhe e ka pasur zgjerimin më të madh vetëm dekadën e fundit. Megjithatë, të dhënat tregojnë se sistemi bankar shqiptar ka pasur një ecuri pozitive e të qëndrueshme, me stabilitet edhe gjatë periudhës së krizës. Rritja e kredive të këqija ekuilibrohet deri diku me rritjen e depozitave nga emigrantët, të cilët së fundmi u besojnë bankave në Shqipëri. Situata e rënduar ekonomike e vendeve fqinje, sidomos ajo e Greqisë, ka ndikuar pozitivisht në lëvizjen e kapitalit monetar (likuiditet i domosdoshëm) drejt sistemit bankar në Shqipëri. Duke qenë se në Shqipëri sistemi bankar është ndërmjetësuesi kryesor financiar duhet trajtuar me kujdes zhvillimi i këtij sistemi si një mundësi e mirë për një rritje të qëndrueshme të ekonomisë në tërësinë e vet.

Marrëdhënia kryesore e një banke me klientin (konsumatorin) kryhet nëpërmjet shërbimeve dhe produkteve bankare. Sa më të zhvilluara e të larmishme të jenë shërbimet dhe produktet bankare aq më të mëdha janë shanset që banka të ketë një numër më të madh klientësh.

Një vështrim mbi shërbimet dhe produktet bankare në Shqipëri, problemet dhe mundësitë e zhvillimit të tyre

Nga ana tjetër, sistemi bankar duhet të zhvillojë ato shërbime dhe produkte që janë në përputhje me preferencat dhe mundësitë financiare të konsumatorit. Kjo në vendet e zhvilluara funksionon më së miri, duke i nxitur bankat në shtimin e shërbimeve dhe produkteve që ato ofrojnë, si dhe duke rritur në këtë mënyrë konkurrencën mes tyre. Bankat në Shqipëri, sidomos vitet e fundit, kanë shtuar produktet dhe shërbimet që ato ofrojnë, por krahasuar me shërbimet dhe produktet që ofrohen nga bankat në vendet e zhvilluara, sistemi bankar shqiptar është ende mbrapa. Bazuar në raportet e vetë bankave si dhe të Bankës së Shqipërisë, dy nga produktet bankare më të përdorura janë depozitat dhe kreditë. Në sistemin bankar shqiptar kemi një përdorim dukshëm të kufizuar të shërbimeve dhe produkteve që ofrohen dhe fokusim të konkurrencës ndërbankare, kryesisht në kushtet e kredive dhe të depozitave. Pse shërbimet dhe produktet e ofruara nga sistemi bankar në Shqipëri ndodhen në një situatë të tillë dhe pse shumë shërbime dhe produkte bankare në Shqipëri nuk gjejnë "treg"? Mendoj se përgjigjja për të gjitha këto pyetje është *mungesa e kulturës ekonomike të konsumatorit shqiptar*.

Konsumatori shqiptar në përgjithësi ka një kulturë modeste ekonomike, e për më tepër një kulturë shumë modeste të përdorimit të sistemit bankar dhe kjo për disa shkaqe. Së pari, vetë historia e Shqipërisë, në të kaluarën e së cilës nuk gjejmë ndonjë moment kur shqiptarët të kenë qenë përdorues

aktiv të ndërmjetësve financiarë, pavarësisht formave të këtyre ndërmjetësve. Së dyti, mundësitë ekonomike të konsumatorit shqiptar në përgjithësi kanë qenë të kufizuara, ashtu si vazhdojnë të jenë edhe sot për një pjesë të mirë të tyre. Vihet re se marrëdhënie me bankën kanë përgjithësisht ata persona që merren me aktivitete fitimprurëse. Së treti, fenomeni i firmave "piramidale" ka rrënjësuar në mendjen e konsumatorit shqiptar mosbesimin e "dorëzimit" të parasë, qoftë edhe në një institucion financiar. Këto tri aspekte, por edhe të tjera, kanë bërë që konsumatori shqiptar të mos ketë kulturën ekonomike të nevojshme që të kanalizojë nëpërmjet sistemit bankar transaksionet e tij. Nga ana tjetër vërehet se, edhe brezi i ri në Shqipëri

...në sistemin bankar shqiptar kemi një përdorim dukshëm të kufizuar të shërbimeve dhe produkteve që ofrohen dhe fokusim të konkurrencës ndërbankare, kryesisht në kushtet e kredive dhe të depozitave.

**APLIKO
TANI**



TË ËNDËRROSH PËR SHTËPINË TËNDE TË RE DO TË THOTË TË ËNDËRROSH PËR NJË TË ARDHME MË TË SIGURT PËR FAMILJEN TËNDE

Prandaj kemi zgjedhur kredinë për shtëpi të Banka Intesa Sanpaolo

SEPSE NA PËLQEN TA PROJEKTOJMË VETE TË ARDHMEN TONË

 **INTESA SANPAOLO BANK**

Drejt të ardhmes me ju.





Bankat në Shqipëri duhet të konsiderojnë ndërmarrjen e nismave të përbashkëta, për të injektuar një frymë të re, atë të frymës së kulturës ekonomike.

në një sportel banke dhe kjo për të paguar detyrimin për studimet e larta, ose për të shoqëruar ndonjë të afërm të tyre.

Duke parë rezultatet e kësaj ankete, natyrshëm lind pyetja: Nëse këta të rinj që kryejnë studimet në fushën e ekonomisë në kryeqytetin e Shqipërisë, ku ndodhet edhe numri më i madh i bankave nuk kanë informacionin bazë mbi sistemin bankar, atëherë cili do të jetë niveli i pritshëm i këtij informacioni në qytete të tjera të vendit si dhe tek të rinjtë që nuk kanë ndonjë lidhje të veçantë me fushën e ekonomisë?

Nisur nga kjo mungesë informacioni tek të rinjtë, gjykohet që bankat duhet të bëjnë më tepër, për të sensibilizuar konsumatorin shqiptar, sidomos brezin e ri, pasi ata do të jenë pashmangmërisht klientët e tyre në një të ardhme të afërt. Kështu, bankat në Shqipëri duhet të konsiderojnë ndërmarrjen e nismave të përbashkëta, për të injektuar një frymë të re, atë të frymës së kulturës ekonomike. Ato duhet të zhvillojnë takime periodike me konsumatorin me qëllim informimin e tij, pasi vetëm spotet publicitare nuk mjaftojnë, por duhen shfrytëzuar kanale dhe metoda të tjera alternative me qëllim rritjen e kulturës ekonomike të konsumatorit shqiptar. Pavarësisht nga kostojat që shoqëron këtë sipërmarrje, ajo patjetër do të sjellë më tepër klientë në dyert e bankave. Bankat nuk duhet të shohin maksimizimin e fitimit vetëm si objektiv afatshkurtër, por duhet të koordinojnë përpjekjet e tyre, në mënyrë që përpara të kenë një të ardhme të sigurt, që garantohet vetëm duke pasur një popullatë me kulturë ekonomike dhe bankare. Kjo do t'u shtojë atyre klientelën, si dhe do t'u japë mundësi të zhvillojnë dhe të ofrojnë më shumë shërbime e produkte të reja, për të maksimizuar fitimin.

ka mungesë thelbësore të kulturës ekonomike, një fakt problematik ky, kur mendohet se të rinjtë janë potencial për klient të sistemit bankar në një të ardhme të afërt.

Nga një anketimi kryer në prill të 2012-ës me 400 studentë të Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës, si dhe me disa studentë në disa universitete të tjera jopublike rezulton se: 81% e tyre nuk kanë informacion se sa banka tregtare ka në Shqipëri; 24% e të rinjve të anketuar pohojnë se nuk kanë nevojë për sistemin bankar, por dhe nuk i njohin produktet dhe shërbimet që sistemi bankar ofron; 74 % nuk mund të përmendin më tepër se 3 shërbime, ose produkte që ofron sistemi bankar e njëkohësisht, 90% e tyre nuk kanë informacion mbi koston e këtyre produkteve, ose shërbimeve. Vetëm 10% e studentëve pohojnë se prindërit e tyre përdorin sistemin bankar për të kryer transaksione (minimalisht pagesa faturash të ndryshme), ndërkohë që, vetëm 37 studentë punonin gjatë kohës së studimeve. Rreth 70% e studentëve të anketuar pohojnë se kanë shkuar minimalisht një herë

AAB DHE IFC PROMOVOJNË ZHVILLIMIN E TREGUT TË EFICIENCËS SË ENERGISJË



Falë një bashkëpunimi të suksesshëm tashmë në faqen e internetit të AAB-së mund të gjeni një link të dedikuar, informues dhe edukues për publikun e gjerë në lidhje me Eficiencën e Energjisë (përkufizimi, përfitimet, rregullat praktike dhe masat/investimet për Eficiencën e Energjisë) dhe Kreditë për Eficiencën e Energjisë (hapat kryesore, procedurat, dokumentet e nevojshme, kostot që përfshihen, kushtet e huasë).

Shoqata Shqiptare e Bankave për zhvillimin e burimeve njerëzore

TRAJNIME PRILL - QERSHOR 2012

Trajnim mbi Menaxhimin e Riskut të Likuiditetit në Bankë, 16-17 prill 2012

AAB organizoi në bashkëpunim me IFC një trajnim dy ditor mbi Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit në Bankë. Trajnimi u ndoq nga 30 menaxherë dhe specialistë të nivelit të lartë të departamenteve të menaxhimit të rrezikut të 15 bankave anëtare dhe dy përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe pati si objektiv identifikimin e shkaqeve kryesore dhe pasojave të rrezikut të likuiditetit në kontekstin e përgjithshëm të rrezikut financiar dhe jo-financiar.



Trajnim mbi Kujdesin ndaj Klientit dhe Aftësitë Negociuese, 17-18 maj 2012

AAB organizoi në maj trajnimin dy ditor me temë "Kujdesi ndaj Klientit dhe Aftësitë Negociuese". Trajnimi u ndoq nga përfaqësuesit e 7 bankave anëtare dhe trajtoi tema të veçanta mbi aftësitë dhe teknikat e kërkuara për punonjësit e bankave që të ofrojnë shërbime cilësore ndaj klientëve dhe të përmbushin objektivat e shitjes përmes një qasjeje vetëbesimi bazuar në nevojat e klientëve dhe përmes aftësive të shëndosha komunikuese ndër-personale.

Trajnim mbi Analizën Bankare, 12-14 qershor 2012

AAB organizoi në bashkëpunim me BACEE një kurs trajnimi intensiv mbi Analizën Bankare. Kursi u ndoq nga 13 pjesëmarrës të bankave anëtare dhe u drejtua nga Z. Istvan Lengyel, Krye-Analist dhe Sekretar i Përgjithshëm i BACEE. Qëllimi i trajnimit ishte analizimi në thellësi i zhvillimeve më të fundit të metodologjisë dhe praktikës së analizës bankare. Një pjesë e mirë e trajnimit iu kushtua zhvillimeve në sferën e mbikëqyrjes së bankës.



Seminar mbi Raportet Financiare në Analizën Bankare, 15 qershor 2012

Në seminarin një ditor mbi përdorimin e Raportëve Financiare në Analizën Bankare që AAB organizoi në bashkëpunim me BACEE, të drejtuar nga z. Istvan Lengyel, morën pjesë 15 punonjës të 10 bankave anëtare. Seminari ishte i përgatitur për kërkues dhe analistë në banka të cilët duhet të kenë njohuri më të mira mbi raportet financiare dhe përdorimin e tyre në analizën e bankës.

Trajnim mbi Menaxhimin e Kompensimit dhe shpërblimit, 14-15 qershor 2012

AAB organizoi në bashkëpunim me Hay Group një kurs trajnimi mbi Aftësitë e Menaxhimit të Pagave, Shpërblimeve dhe Përfitimeve. Qëllimi i trajnimit ishte të mbështeste profesionistët e Burimeve Njerëzore në fushën e analizës, interpretimit dhe përdorimit eficient të politikave të pagës; lidhjes së ngushtë të strategjisë së organizatës me shpërblimet dhe praktikatat aktuale të pagës të lidhura me politikën e pagës së dëshiruar.



Seminar mbi Menaxhimin e Kredive me Probleme, 18 qershor 2012

Në bashkëpunim me Misionin e USAID, Tiranë - Programi FSVC, AAB organizoi më 18 qershor 2012, një seminar një ditor për bankierët, mbi teknikat e përdorura për huatë me probleme. Programi adresoi çështje të menaxhimit të këtyre huave lidhur me parandalimin, njohjen e huave potenciale me probleme dhe veprimet e nevojshme për kthimin e tyre. Seminari u ndoq nga 36 zyrtarë të huave, menaxherë të portofolit dhe oficerë të kredisë nga të gjitha bankat anëtare.

Trajnim mbi Standardet Financiare Ndërkombëtare të Raportimit (IFRS)- Nivel i Ndërmjetëm, 20-22 qershor 2012

AAB organizoi një kurs tre ditor trajnimi, mbi "IFRS- Moduli i Ndërmjetëm" i cili pasoi trajnimin e organizuar në Shkurt të këtij viti mbi "IFRS-Moduli Prezantues". Kursi trajtoi veçanërisht IFRS-të që rregullojnë aktivitetin bankar dhe që tashmë kërkohen të aplikohen nga bankat në Shqipëri.



Trajnim mbi Menaxhimin e Rrezikut të Portofolit të Huasë, 26-27 qershor 2012

AAB në bashkëpunim me Misionin USAID, Tiranë dhe Assist Impact, organizoi një trajnim dy ditor mbi "Menaxhimin e Rrezikut të Portofolit të Huasë", i cili u ndoq nga 24 punonjës të nivelit të lartë në Departamentet e Rrezikut të 12 bankave. Objektivat e kursit ishin: identifikimi i praktikave më të mira në ndërtimin dhe mbajtjen e një portofoli huaje të sigurt; përdorimi i modeleve matematikore për stress teste reale; dhe gjetja dhe zbatimi i zgjidhjeve për menaxhimin e riskut të huasë.

